



Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosovo
Qeveria – Vlada – Government
Ministria e Drejtësisë – Ministarstvo Pravde – Ministry of Justice

STRATEGJIA
PËR
SUNDIMIN E LIGJIT
2021-2026

Korrik, 2021

PËRMBAJTJA

<i>Lista e shkurtesave</i>	3
PËRMBLEDHJE EKZEKUTIVE	5
1.0. HYRJE	7
2.0. METODOLOGJIA	8
3.0. SFONDI	10
4.0. VIZIONI DHE OBJEKTIVAT E STRATEGJISË PËR SUNDIMIN TË LIGJIT	24
5.0. ARANZHIMET E ZBATIMIT, MONITORIMIT DHE RAPORTIMIT	40
6.0. NDIKIMI BUXHETOR DHE ZBATIMI I STRATEGJISË	45
7.0. PLANI I VEPRIMIT DHE ZBATIMI I DOKUMENTIT	49

Lista e shkurtesave

AAPSK – Agjencia e Administrimit të Pasurive të Sekuestruara dhe të Konfiskuara

AD – Akademia e Drejtësisë së Kosovës

AKK – Agjencia Kundër Korrupsionit

ANJF – Agjencia për Ndihmë Juridike Falas

ATK – Administrata Tatimore e Kosovës

BE – Bashkimi Evropian

CEPEJ – Komisioni Evropian për Efikasitetin e Drejtësisë

ERA – Agjenda për Reforma Evropiane

EULEX – Misioni i Bashkimit Evropian për Sundimin e Ligjit në Kosovë

GJEDNJ – Gjykata Evropiane e të Drejtave të Njeriut

IAP – Institucioni i Avokatit të Popullit

IPK – Inspektoriati Policor i Kosovës

KEDNJ – Konventa Evropiane për të Drejtat e Njeriut

KGJK – Këshilli Gjyqësor i Kosovës

KiE – Këshilli i Evropës

KPK – Këshilli Prokurorial i Kosovës

MD – Ministria e Drejtësisë

MPB – Ministria e Punëve të Brendshme

MSA – Marrëveshja e Stabilizim Asociimit

OAK – Oda e Avokatëve të Kosovës

OJQ – Organizata Joqeveritare

OSHC – Organizatat e Shoqërisë Civile

PK – Policia e Kosovës

PKZMSA – Programi Kombëtar për Zbatimin e Marrëveshjes së Stabilizim-Asociimit

PLL – Profesionet e Lira Ligjore

PSRK – Prokuroria Speciale e Republikës së Kosovës

RFSSL – Rishikimi FunkSIONAL i Sektorit të Sundimit të Ligjit

SHKK – Shërbimi Korrektues i Kosovës

SHSK – Shërbimi Sprovues i Kosovës

SMIL – Sistemi i Menaxhimit Informativ të Lëndëve

UNDP – Programi i Kombeve të Bashkuara për Zhvillim

USAID – Agjencia Amerikane për Zhvillim Ndërkombëtar

ZAK – Zgjidhja alternative e kontesteve

PËRMBLEDHJE EKZEKUTIVE

Sektori i sundimit të ligjit në Republikën e Kosovës ballafaqohet me sfida nga më të ndryshmet. Kjo ka ndikuar që besimi në institucionet e Kosovës të jetë i ulët. Marr parasysh këtë, Qeveria e Kosovës në bashkëpunim me Këshillin Gjyqësor dhe atë Prokurorial, si dhe institucionet tjera në këtë sektor, por edhe shoqërinë civile dhe donatorët ndërkombëtarë, vite më parë kanë lansuar Procesin e Rishikimit FunkSIONAL të Sektorit të Sundimit të Ligjit.

Ky proces ka kaluar në disa faza dhe pas një konsultimi gjithëpërfshirës, ka identifikuar në mënyrë specifike të metat e sektorit që janë të fokusuar kryesisht në sektorin e drejtësisë. Këto të meta dhe rekomandimet për adresimin e tyre janë listuar në 16 (gjashtëmbëdhjetë) dokumente të politikave, të grupuara në katër shtylla: (1) sistemi gjyqësor dhe prokurorial; (2) drejtësia penale (3) qasja në drejtësi dhe shërbimet jo-gjyqësore; dhe (4) anti-korrupsioni. Bazuar në këto dokumente, është zhvilluar Strategjia për Sundimin e Ligjit.

Strategjia është pesë vjeçare, zbatimi i saj do të filloj në mesin e vitit 2021 dhe e njëjta do të skadoj në mesin e vitit 2026. Ajo ndahet në gjithsej 7 (shtatë) kapituj. Kapitulli i parë është hyrja e Strategjisë që shpjegon arsyet për iniciimin e Strategjisë, që në fakt është gjendja jo e mirë në sektor si dhe ndërlidhjen e Strategjisë me prioritetet e Qeverisë, gjegjësisht parandalimin dhe luftimin e krimit dhe angazhimin për respektimin e të drejtave të njeriut dhe barazisë gjinore, por edhe avancimin e Kosovës në procesin e integritimit evropian.

Kapitulli i dytë shpjegon qasjes analitike të përdorur për hartimin e Strategjisë si dhe thekson rolin e Ministrisë së Drejtësisë, si bartëse kryesore e këtij procesi, këshillave – atij gjyqësor dhe prokurorial, Akademisë së Drejtësisë, Ministrisë së Punëve të Brendshme, Policisë së Kosovës, Agjencisë Kundër Korrupsionit dhe organeve tjera, përfshirë edhe shoqërinë civile dhe donatorët, në zhvillimin e analizave relevante për këtë Strategji dhe hartimin e saj.

Kapitulli i tretë shpjegon gjendjen aktuale në sektor dhe përkufizon problemin që sektori ende ka të meta në administrimin e shpejtë dhe efektiv të drejtësisë. Në mënyrë më specifike, problematika e identifikuar në sektor është ndarë në tri komponenta. Komponenta 1 - funksionimi i gjyqësorit, ku theksohen vonesat në sistem, përfshirë numrin e lëndëve të pa zgjidhura; pastaj nevoja për rritje të profesionalizmit, ku mungojnë aspekti i planifikimit të duhur trajnimeve dhe trajnimet e duhura specifike; tutje llogaridhënia e pamjaftueshme, gjegjësisht problemet me vlerësimin e performancës së gjyqtarëve dhe prokurorëve; si dhe cenueshmëria e sistemit gjyqësor dhe prokurorial nga akterët e jashtëm, apo mungesa e një sistemi të duhur të verifikimit dhe kontrollit të integritetit. Komponenta 2 - drejtësia penale, identifikon problemet në këtë fushë, kryesisht në parandalimin dhe luftimin e krimit të organizuar dhe korrupsionit, apo mungesën e kapaciteteve, koordinimit dhe vullnetit në këtë drejtim si dhe mos-funksionimin adekuat të sistemit të konfiskimit të pasurisë së përdorur ose fituar përmes veprës penale; si dhe problemet në ekzekutimin e sanksioneve penale, përdorimin e vogël të masave alternative, por edhe nevojën për ngritjen e sistemit sprovues, gjegjësisht kapaciteteve të SHSK-së në bashkëpunim edhe me SHKK-në. Komponenta 3 - qasja në drejtësi, theksohen pengesat e qasjes së qytetarëve dhe qytetareve në

gjykata dhe prokurori, veçanërisht sa i përket grupeve të cënueshme, sfidat me mjetet juridike sidomos mungesën e tyre që duhet të jenë efektive për të adresuar problemin e periudhave të gjata të trajtimit të lëndëve në gjykatat e Kosovës, ngecjet në bashkëpunimin me shoqërinë civile, problemet lidhur me ofrimin e shërbimeve ligjore nga profesionet e lira, sidomos përdorimi i ulët i ndërmjetësimit, arbitrazhit dhe procedurave të falimentimit, por edhe nevojën për monitorimin e duhur të tyre, si dhe përfundimisht rolin dhe kapacitetet e limituara të Ministrisë së Drejtësisë, në raport me politikëbërjen të bazuar në të dhëna dhe në avancimin në procesin e integritetit evropian në përgjithësi.

Kapitulli 4 i Strategjisë thekson vizionin e Strategjisë që është rikthimi i besimit të qytetarëve dhe qytetareve në drejtësi, sistem gjyqësor e prokurorial. Ky Kapitull gjithashtu liston objektivat që synohen të arrihen përmes Strategjisë dhe masave që do të ndërmerren, sa i përket të gjitha fushave të lartpërmendura. Ndërlidhur me Objektivat, gjithashtu në Strategji theksohen indikatorët për matjen e suksesit të Strategjisë.

Aranzhimet e zbatimit, monitorimit dhe raportimit janë të cekura në Kapitullin 5 të Strategjisë, ku cekën strukturat institucionale koordinuese në këtë drejtim, gjegjësisht 1) Ministria e Drejtësisë; 2) Organi koordinues ndërinstytucional dhe 3) Komiteti Drejtues i Strategjisë. Raportet për zbatimin e Strategjisë parashihet të jenë në baza gjashtë-mujore dhe vjetore. Strategjia parashihet t'i nënshtrohet rishikimit afatmesëm, jo më larg se deri në fillim të vitit 2024 për të vlerësuar efektivitetin dhe efikasitetin e zbatimit të saj, ndërsa vlerësimi përfundimtar i Strategjisë parashihet të bëhet në fund. Kapitulli 6 i Strategjisë paraqet ndikimin buxhetor që parashihet të kenë aktivitetet e parapara.

Pjesë integrale e Strategjisë është edhe Plani i Veprimit, ku në mënyrë specifike janë paraqitur të gjitha aktivitetet, në kuadër të masave të politikave, që parashihet të ndërmerren nga Qeveria, Ministria e Drejtësisë, KGJK, KPK, Akademia e Drejtësisë, Policia e Kosovës dhe institucionet tjera publike për të adresuar problemet e identifikuara dhe arritur objektivat e synuara. Në plan të veprimit janë caktuar treguesit e rezultateve për secilin aktivitet, që kontribuojnë në objektivat tjerë specifik dhe të përgjithshëm krahas indikatorëve të cekur si më lartë.

1.0. HYRJE

Sundimi i ligjit është një ndër parimet kryesore të rendit kushtetues të Republikës së Kosovës. Në këtë drejtim, Qeveria e Republikës së Kosovës gjithashtu ka përcaktuar në programin e saj sundimin e ligjit si parim themelor mbi të cilin do të punojë, me qëllimin kryesor mbrojtjen dhe garantimin e të drejtave dhe lirive të qytetarëve dhe qytetareve. Në mënyrë më specifike, vizioni i Qeverisë është drejtësia e pavarur, e paanshme, efikase dhe profesionale, dhe kjo synohet të arrihet me anë të fuqizimit të sistemit të drejtësisë dhe rritjes së besimit qytetar.¹ Kjo është në përputhje të plotë me qëllimin e Procesit të Rishikimit Funkcional të Sektorit të Sundimit të Ligjit, të filluar në vitin 2016. Puna disa vjeçare e bërë gjatë këtij procesi, ka rezultuar në këtë Strategji për Sundimin e Ligjit.

Kjo Strategji përmes aktiviteteve të parapara do të kontribuoj gjithashtu në arritjen edhe të prioriteteve tjera të Qeverisë, siç janë parandalimi dhe luftimi i krimit, si dhe angazhimit për respektimin e të drejtave të njeriut të garantuara me Kushtetutë e konventa ndërkombëtare dhe arritjes së barazisë gjinore. Strategjia sa i përket aspektit gjinor, synon sigurimin e përfaqësimit të barabartë të grave në vendimmarrje në të gjitha nivelet në sektorin e sundimit të ligjit, si mënyra e vetme për të arritur në mënyrë efektive barazinë gjinore, përfshirë edhe përforcimin e mekanizmave institucionale dhe ngritjen e vetëdijes shoqërore për qasjen në drejtësi. Strategjia ka rëndësi të veçantë edhe në procesin e integritimit evropian të Kosovës, ngase përmes saj kontribuohet drejtpërdrejtë në zbatimin e MSA-së.

Procesi i Rishikimit Funkcional dhe hartimi i Strategjisë janë iniciuar me të kuptuar nevojën për një reformë gjithëpërfshirëse të sektorit, për të adresuar problemet ligjore dhe ato praktike të evidentuara qoftë nga vet Qeveria, institucionet tjera shtetërore, raportet ndërkombëtare, shoqëria civile, por edhe qytetarët e qytetaret.

Ky proces është udhëhequr nga Ministria e Drejtësisë, sipas vendimit të Qeverisë, në bashkëpunim me ministritë tjera relevante, institucionet e gjyqësorit dhe prokurorisë dhe ato tjera shtetërore, si dhe përfshirë partnerët ndërkombëtar, shoqërinë civile dhe publikun në përgjithësi.

Kjo Strategji është në përputhje me kornizën e integruar të planifikimit në Kosovë, pra ajo parashihet të funksionoj në mënyrë koherente, efikase dhe të integruar, me dokumentet tjera planifikuese të Qeverisë, gjegjësisht ato të planifikimit të politikave dhe të planifikimit buxhetor. Strategjia në fushëveprim kryesor ka sistemin e drejtësisë në Kosovë, por edhe elemente që ndërlidhen me këtë sistem siç janë puna e Policisë së Kosovës ose veprimet e institucioneve në parandalimin dhe luftimin e korrupsionit. Në këtë drejtim, në sektorin e sundimit të ligjit mund të ketë edhe dokumente tjera planifikuese të Qeverisë ose institucioneve tjera, qoftë të natyrës horizontale por edhe ato specifike të brendshme, të cilat natyrisht duhet të jenë në harmoni të plotë me këtë Strategji dhe kornizën e integruar të planifikimit në Kosovë.

¹ Programi i Qeverisë së Kosovës 2021-2025, faqe 12. I qasshëm në: <https://kryeministri-ks.net/wp-content/uploads/2021/05/Programi-i-Qeverise-se-Kosoves-2021-2025.pdf>

Në mënyrë specifike, hartimi i kësaj Strategjie është paraparë në Planin Vjetor të Punës së Qeverisë, Planin e Dokumenteve Strategjike, Agjendën për Reforma Evropiane (ERA 2) dhe Planin Kombëtar të Zbatimit të MSA-së.

Strategjia përbëhet nga gjithsej 6 kapituj. Pas këtij kapitulli (1), pason Metodologjia (2), Sfondi (3), Objektivat (4), Aranzhimet e zbatimit, monitorimit dhe raportimit (5) dhe Ndikimi buxhetor (6). Plani i veprimit është pjesa përmbyllëse e kësaj Strategjie, ku përcaktohen aktivitetet që do të ndërmerren për zbatimin e saj.

2.0. METODOLOGJIA

Kjo strategji është produkt i procesit të Rishikimit Funkcional të Sektorit të Sundimit të Ligjit (RFSSL). RFSSL ishte dizajnuar në atë mënyrë që të ofrojë analizë të thuktë dhe të detajuar të problemeve në fushën e sundimit të ligjit. Hartimit të strategjisë i kanë paraprirë dy faza të tjera zhvillimore në kuadër të RFSSL-së.

Faza e parë e RFSSL-së, që ka përfunduar në fund të vitit 2018, është përqendruar në një analizë të gjerë të çështjeve që ndikojnë në funksionimin e sektorit të sundimit të ligjit. Produkt i kësaj faze ishin gjashtë analiza paraprake, të cilat kanë shtruar rrugën për analiza të mëtutjeshme.

Faza e dytë e RFSSL-së, e cila është zhvilluar përgjatë vitit 2019 është fokusuar në analiza të thella të prioritetëve të politikave dhe ndërhyrjeve që dolën nga analiza paraprake. Kjo fazë e procesit është zhvilluar përmes Dokumenteve të Politikave, të cilat kanë ofruar një analizë të thuktë të kornizës ligjore, efikasitetit dhe bashkërendimit institucional, si dhe shkathësive profesionale në sektorin e sundimit të ligjit.

Temat e këtyre Dokumenteve janë identifikuar pas diskutimeve gjithëpërfshirëse dhe me pjesëmarrje aktive të të gjitha institucioneve që punojnë në këtë sektor. Dokumentet e politikave, gjithsej 16 sosh, përbëjnë bërthamën e procesit të Rishikimit, të grupuara në katër shtylla: (1) sistemi gjyqësor dhe prokurorial; (2) drejtësia penale (3) qasja në drejtësi dhe shërbimet jo-gjyqësore; dhe (4) anti-korrupsioni.

Analizat dhe Dokumentet e Politikave janë prodhuar me ekspertizë dhe përkrahje të BE-së, Ambasadës së SHBA-së, USAID, Ambasadës Britanike dhe UNDP-së. Secili dokument i politikave diskuton edhe metodologjinë e përdorur në të. Kryesisht, metodat e përdorura për mbledhjen e të dhënave për analiza kanë qenë shqyrtimi i legjislacionit dhe dokumenteve e analizave të prodhuara më parë, përfshirë këtu raporte të monitorimit, anketat e përdoruesve të gjykatave, statistikave dhe të dhënat nga vetë institucionet e analizuar. Gjithashtu, metodë tjetër e rëndësishme në përpilimin e dokumenteve të politikave kanë qenë intervistat me institucionet dhe personat zyrtarë me interes.

Të gjitha dokumentet analitike të zhvilluara, gjatë procesit të hartimit dhe me përfundimin e tyre, i janë nënshtruar një procesi gjithëpërfshirës të konsultimeve. Punëtori të veçanta janë organizuar

për secilin dokument të prodhuar, gjatë së cilave është diskutuar përmbajtja, të gjeturat dhe rekomandimet e tyre. Më pas, komentet e pjesëmarrësve janë integruar në dokument. Kështu, janë mbajtur mbi 45 punëtori dhe takime publike që kanë tërhequr mbi 1,000 pjesëmarrës nga qeveria, gjyqësori, donatorët dhe shoqëria civile. Me përfundimin e kësaj faze, në mars të vitit 2020, u organizua takimi i Komitetit Drejtues, në kuadër të së cilit u diskutuan gjetjet dhe rekomandimet kryesore të kësaj faze. Ato u miratuan në parim nga i gjithë Komiteti Drejtues, dhe MD-së iu dha një dritë e gjelbër për të vazhduar me fazën e fundit.

Faza e tretë dhe e fundit e këtij procesi ishte hartimi i kësaj strategjie, duke përdorur si bazë gjetjet dhe rekomandimet e dala nga Dokumentet e Politikave. Puna për hartimin e strategjisë është ndarë në dy nivele: në punën e Ekipit Qendror Punues për hartimin e strategjisë, si dhe në punën në nën-grupet punuese për secilin nga katër kapitujt e lartpërmendur. Ndonëse ishte planifikuar që hartimi i Planit të Veprimit si dhe të gjitha seksioneve të strategjisë të bëhej nga nën-grupet, përmes organizimit të punëtorive të veçanta, kjo u pamundësua për shkak të paraqitjes së pandemisë së Covid-19. Prandaj, metodologjia e punës pësoi ndryshime, duke u fokusuar tashmë në takime online, dhe hartim paraprak të drafteve të dokumenteve nga MD, e të cilat më pas dërgoheshin tek institucionet tjera për komente dhe kontribut.

Institucionet hisedare të këtij procesi, gjatë fazave të ndryshme të tij, janë: Këshilli Gjyqësor i Kosovës (KGJK), Këshilli Prokurorial i Kosovës (KPK), Akademia e Drejtësisë (AD), Ministria e Punëve të Brendshme (MPB), Policia e Kosovës (PK), Agjencia Kundër Korrupsionit (AKK), Gjykata Supreme, Gjykata e Apelit, Universiteti i Prishtinës (UP), Oda e Avokatëve të Kosovës (OAK), Prokuroria Speciale e Kosovës, Prokuroria e Shtetit, Prokuroria e Apelit, ATK, Dogana e Kosovës, Agjencitë brenda MD-së: Shërbimi Korrektues i Kosovës (SHKK), Shërbimi Sprovues i Kosovës (SHSK), Agjencia për Administrimin e Pasurisë së Sekuestruar ose të Konfiskuar (AAPSK), pastaj Oda e Noterëve, Oda e Përmbauesve Privatë, Asociacioni i Ndërmjetësuesve, Agjencia për Ndihmë Juridike Falas (ANJF), Avokati i Popullit, AAPSK, Përfaqësues të Zyrës së BE-së dhe EULEX, USAID, UNDP, Zyra e Presidentit, si dhe Odat Ekonomike – ajo e Kosovës, Gjermane dhe Amerikane.

Strategjia ka kaluar një proces të konsultimit në pajtim me rregullativën e aplikueshme ligjore në Kosovë, në të cilën kanë marr pjesë institucionet zbatuese të projektit, organizatat e shoqërisë civile dhe organizatat ndërkombëtare, si dhe përfaqësuesit e misionëve të shteteve të caktuara në Kosovë, të cilat përmes ekspertizës së tyre kanë ofruar komente, rekomandime, propozime dhe të dhëna specifike të cilat e kanë pasuruar tutje Strategjinë dhe e kanë bërë atë më praktike.² Në të gjitha takimet konsultuese të mbajtura ka pasur një përfaqësim përfaqësues të barabartë të burrave dhe grave.

² Për më shumë shih Raportin e Konsultimit Publik për Strategjinë e Sundimit të Ligjit. I qasshëm në: <https://konsultimet.rks-gov.net/viewConsult.php?ConsultationID=41053>

3.0. SFONDI

Sektori i sundimit të ligjit në Kosovë ka shënuar përparim të rëndësishëm, veçanërisht pas shpalljes së pavarësisë së Kosovës, në vitin 2008. Institucionet dhe legjislacioni kryesor në këtë fushë janë konsoliduar dhe reformuar vazhdimisht, në partneritet me komunitetin ndërkombëtar dhe shoqërinë civile, me synim të arritjes së rezultateve më të mira. Me gjithë progresin e arritur, sektori ende ka të meta në administrimin e shpejtë dhe efektiv të drejtësisë, dhe si rrjedhojë ka besim mjaft të ulët të publikut në të.

Problemet ende janë të shumta dhe të natyrave të ndryshme. Ky është konstatim i përgjithshëm dhe mjaft evident të cilin e bëjnë Qeveria, komuniteti ndërkombëtar që vepron në Kosovë, shoqëria civile, qytetarët e qytetaret që janë ballafaquar me sistemin, por edhe vet pjesëtarët e sistemit.

Për të kuptuar në mënyrë më specifike problemet e sektorit të sundimit të ligjit, hulumtim më i thellë ka qenë i nevojshëm. Kjo për të kuptuar se çfarë dhe kush po e pengon konsolidimin e plotë të këtij sektori, dhe çfarë duhet të bëjnë institucionet dhe palët e përfshira për të adresuar problemet. Ky hulumtim është zhvilluar përmes Procesit të Rishikimit Funkcional të këtij sektori, duke përdorur metoda dhe mjete të caktuara. Në këtë drejtim, janë mbledhur dhe analizuar nga aspekti ligjor dhe ai praktik i zbatimit, të dhëna të konsiderueshme për problemet e sektorit, faktorët dhe efektet e tyre për shoqërinë e Kosovës, përmbledhja e të cilave do të prezantohet në vijim.

Këto të dhëna janë krahasuar kundrejt standardeve ndërkombëtare dhe evropiane të sektorit të sundimit të ligjit, kryesisht atyre të Këshillit të Evropës dhe të BE-së, të organeve të tyre apo të mbështetura nga to, duke marr parasysh me theks të veçantë detyrimet e Kosovës në procesin e anëtarësimit në BE. Gjithashtu janë shqyrtuar shembuj të vendeve të tjera varësisht nga konteksti që trajtohet, si SHBA, Gjermania, Italia, Sllovenia, Kroacia dhe të tjera.

Problemet në sundimin e ligjit kanë efekte mjaft negative për shoqërinë e Kosovës. Ato janë shkelja e të drejtave të njeriut dhe pengimi i zhvillimit ekonomik, mungesa e investimeve, përfshirë ato të huaja dhe zhvillimit shoqëror, ku theksohet rritja e varfërisë, krimeve, infrastruktura më e dobët publike, ngecjet në inovacion, zvogëlimi i cilësisë së jetesës, mundësi më të vogla të aktivitetit për sektorin privat dhe shumë të tjera.

Marrë parasyshë se korniza ligjore dhe ajo institucionale e sektorit të sundimit të ligjit është avancuar në mënyrë të konsiderueshme, siç është cekur më lartë, nga të dhënat e mbledhura, është kuptuar se shkaku kryesor ose më i shpeshtë për ngecjet në konsolidim të plotë të sistemit ka të bëjë me zbatimin jo të duhur të legjislacionit. Si rrjedhojë edhe veprimet për reformimin e sistemit janë të drejtuara kryesisht në këtë aspekt. Mirëpo, kjo nuk përjashton ndryshimet e nevojshme legjislative, si dhe të praktikave aktuale institucionale, me synim arritjen e objektivave të kësaj strategjie.

Përveç faktorëve të zbatimit jo të duhur (1), që përfshin raste kur rregullat e caktuara nga korniza ekzistuese e legjislacionit nuk zbatohen fare ose zbatohen në mënyrë të gabuar, janë edhe dy

faktorë të tjerë të rëndësishëm që kanë shkaktuar problemet në sektorin e sundimit të ligjit. Këto janë: (2) mangësitë ligjore dhe rregullative – raste kur rregullat janë të pakompletuara, kontradiktore ose të vjetërsuara, dhe (3) praktika institucionale – raste kur mungon bashkëpunimi në mes të institucioneve, mendimi strategjik ose vullneti për të arritur rezultate të rëndësishme.

Për qëllime të prezantimit të problemeve të identifikuara në këtë Kapitull, ato janë ndarë në tri grupe që kanë të bëjnë me: (1) Funksionimin e gjyqësorit, (2) Drejtësinë penale dhe (3) Qasjen në drejtësi. Në vijim, në kuadër të këtyre tri grupeve, do të paraqitet pra përmbledhja e të gjeturave kryesore, gjegjësisht problemet, faktorët e tyre dhe informatat se si janë zhvilluar këto probleme gjatë kohës.

3.1. Funksionimi i gjyqësorit

Për funksionimin e duhur dhe të pavarur të gjyqësorit, janë katër elemente kyçe: efikasiteti, profesionalizmi, llogaridhënia dhe integriteti. Problemet kryesore aktuale lidhur me këto katër elemente, janë paraqitur në tabelën në vijim.

Tabela 1 – Problemet kryesore të identifikuara për funksionimin e gjyqësorit



**Funksionimi i
Gjyqësorit**

PROBLEMET

- Vonesat në sistemin gjyqësor dhe prokurorial
- Nevoja për rritje të profesionalizmit dhe kompetencës
- Llogaridhënia e pamjaftueshme
- Sistemi i cenueshëm ndaj akterëve të jashtëm

Vonesat në sistemin gjyqësor dhe prokurorial³


Kohëzgjatja e procedurave mbetet një nga çështjet më kritike dhe komplekse të sektorit të sundimit të ligjit. Ajo ndikon drejtpërdrejtë në të drejtën për gjykim brenda një afati të arsyeshëm, siç përcaktohet me Kushtetutë dhe KEDNJ. Deri tani janë ndërmarrë reforma të rëndësishme për të adresuar këtë problem. Për gjyqtarë dhe prokurorë, për monitorimin e efikasitetit, zbatohet ‘norma e orientuar’ si dhe Sistemi i Menaxhimit Informativ të Lëndëve (SMIL). Ky i fundit është

³ Shih gjithashtu dokumentin e politikave ‘Rritja e efikasitetit të sistemit gjyqësor dhe prokurorial’, 2019.

gjithashtu duke funksionuar për disa vite, ndonëse jo në mënyrë të plotë. Mekanizmat për zgjidhje alternative të kontesteve (ZAK), përmes ndërmjetësimit dhe arbitrazhit, ekzistojnë dhe janë forcuar ndër vite. Gjithashtu, me ndryshimin e legjislacionit vitet e fundit, noterët kanë kompetencë për një numër të konsiderueshëm të lëndëve jo-kontestimore, që më herët janë trajtuar nga gjykatat.

Pavarësisht që objektivi i tërë këtyre reformave ka qenë ulja e lëndëve të grumbulluara në gjykata⁴, ato pjesërisht kanë ofruar rezultatet e synuara dhe numri i lëndëve të pazgjidhura ende mbetet jashtëzakonisht i lartë.

Tabela 2 – Trendi i lëndëve të pazgjidhura gjatë viteve⁵



Nga lëndët e grumbulluara, problematike në veçanti është kohëzgjatja e lëndëve civile dhe atyre administrative. Në anën tjetër, tek Prokuroria vërehet një trend mjaft pozitiv, i rënies së lëndëve të grumbulluara, edhe pse ka ende vonesa gjatë zbatimit të procedurave.

Faktorët kryesorë që kanë ndikuar në numër të madh të lëndëve të grumbulluara janë të ndryshëm. Së pari, në bazë të hulumtimit të bërë, vërehet se ka alokim jo të duhur të burimeve njerëzore në raport me ngarkesën e lëndëve në gjykata. Kjo vjen edhe si rezultat i mbledhjes jo-konsistente të statistikave dhe mungesës së sistemeve gjithëpërfshirëse të IT-së për gjykatat dhe prokuroritë. Shembulli më i mirë i alokimit jo të duhur të burimeve është Gjykata Themelore e Prishtinës. Në nivel të vendit, proporcioni i përqindjes së lëndëve të pazgjidhura që i përkasin kësaj Gjykate, është shumë i më lartë, krahasuar me përqindjen e gjyqtarëve të caktuar për të punuar aty.

⁴ Ato më të vjetra se 2 vite

⁵ Raporti Statistikor Vjetor i KGJK-së për 2015-2018

Faktori i dytë për kohëzgjatjen e procedurave janë të metat e procedurave të brendshme. Edhe pse ka filluar shpërndarja automatike e lëndëve në fillim, gjatë procedurës afatet ligjore për veprimet e caktuara shpesh nuk respektohen si dhe ka shtyrje të shpeshta të seancave, për të cilat nuk ndërmerren sanksionet e duhura. Praktikë e shpeshtë është gjithashtu që lëndët të kthehen në rigjykim nga gjykatat më të larta, duke zgjatur edhe më shumë kohëzgjatjen për zgjidhjen e tyre. Ndikim në këtë drejtim kanë edhe kapacitetet e limituara menaxheriale të kryetarëve të gjykatave, gjegjësisht kryeprokurorëve.

Faktori i tretë është përdorimi i ulët i mundësisë për ZAK. Pavarësisht rregullativës ligjore, kryesisht të mirëfilltë për arbitrazhin dhe sidomos për ndërmjetësimin, palët rrallë herë i përdorin ato. Palët janë pak të informuara për mundësitë që ato i krijojnë për zgjedhje efikase të kontesteve.

Struktura e papërputhshme e gjyqësorit në raport me legjislacionin është faktori i katërt. Kjo më së miri shfaqet në aspektin e drejtësisë komerciale, por edhe administrative, ku dy Departamente, ai për Çështje Administrative dhe tjetri për Çështje Ekonomike, në kuadër të Gjykatës Themelore të Prishtinës, kanë mandat të paqartë dhe ndonjëherë të dyja juridiksion për çështje të ndryshme brenda një kontesti. Ky fakt i detyron shpesh bizneset të ndajnë rastin e tyre dhe mos të drejtohen në një adresë të vetme gjyqësore. Kjo është sfiduese ngase edhe vet këto departamente i kanë mundësitë e limituara për të shkëmbyer të dhëna dhe informata në mes vete. Përveç kësaj, ato nuk kanë burime të mjaftueshme për zgjidhjen e këtyre rasteve, veçanërisht në angazhimin e ekspertëve për zgjidhjen e çështjeve më të komplikuar si dhe ndërlidhjen me të dhënat e institucioneve tjera, si për shembull në fushën e tatimeve, regjistrin të bizneseve, prokurimit dhe të tjera.⁶

Legjislacioni i ndërlidhur konsiderohet faktor tjetër kryesor i kohëzgjatjes së procedurave. Nëse merret shembulli i cekur si më lartë, i drejtësisë komerciale, legjislacioni i asaj fushe nuk është i konsoliduar, me kontradikta përbrenda, që vështirëson tutje zgjidhjen e shpejtë të rasteve.⁷ Kjo vlen edhe për të drejtën civile, veçanërisht për legjislacionin e të drejtave pronësore. Për më shumë, në këtë pjesë vlen të theksohet se përfaqësimi i grave në përgjithësi në sistem, dhe veçanërisht në pozita menaxheriale, është dukshëm më i ulët se sa i burrave.

Gjithashtu, vlen të theksohet se gjatë vitit 2020, por edhe pjesërisht në vitin 2021, pandemia COVID-19 ka shkaktuar pasoja ndër të tjera edhe në efikasitetin e sistemit gjyqësor dhe prokurorial. Si KGJK ashtu edhe KPK gjatë vitit 2020, kanë miratuar plane të veprimit për menaxhimin e krizës.⁸

Pavarësisht, nga analiza e të dhënave të ofruara nga KGJK, sa i përket rasteve administrative në shkallën e parë, pavarësisht se ka pasur 40% raste më pak të pranuar gjatë vitit 2020 në krahasim

⁶ Shih gjithashtu dokumentin e politikave 'Drejtësia komerciale', 2019.

⁷ Ibid.

⁸ Shih KGJK – Plani i Veprimit për Menaxhimin e Krizës 01/267 i datës 02.06.2020, i qasshëm në: https://www.gjyqesori-rks.org/wp-content/uploads/reports/69352_KGJK_Plani_veprimit_per_menaxhimin_krizes.pdf dhe KPK - Plani i Veprimit për Menaxhimin e Krizës i qasshëm në: <https://www.prokuroria-rks.org/assets/cms/uploads/files/Dokumente%20Publikime/KPK/Plane%20e%20Punes/Plani%20i%20Veprimit%20p%C3%ABr%20Menaxhimin%20e%20Kriz%C3%ABs.pdf>

me vitin paraprak, janë zgjidhur 34% më pak raste. Te rastet civile ndikimi nuk ka qenë domethënës. Megjithatë, koha në dispozicion për zgjidhjen rasteve si administrative ashtu edhe civile është rritur për 51%, përkatësisht 25%.

Ngjashëm, gjatë vitit 2020 ka pasur rënie të theksuar të efikasitetit edhe në zgjidhjen e rasteve penale. Pavarësisht se janë pranuar 21% më pak raste të veprave të rënda penale krahasuar me vitin 2019, janë zgjidhur 38% me pak raste në krahasim me po të njëjtin vit. Situata ka qenë edhe më e rënduar sa i përket efikasitetit në zgjidhjen e rasteve të lehta penale (kundërvajtjes). Gjatë vitit 2020 janë zgjidhur 85% më pak raste në krahasim me vitin 2019. Si rrjedhojë, koha në dispozicion për zgjidhjen e rasteve të rënda penale është rritur për 66%, ndërkaq për rastet e veprave penale të lehta (kundërvajtjes) është rritur tejmasë në krahasim me vitin e paraprak.

Edhe në shkallën e dytë ka pasur rënie të ndjeshme të efikasiteti gjatë vitit 2020. Nga të dhënat e këtij viti, rezulton se janë zgjidhur 11% më pak raste civile dhe 25% më pak raste administrative të shkallës së dytë, në krahasim me vitin 2019. Si pasojë, edhe koha në dispozicion është rritur për 1% tek rastet civile dhe 76% tek rastet administrative. Situata e ngjashme ka qenë edhe sa i përket efikasitetit në zgjidhjen e rasteve penale në shkallën e dytë. Gjatë vitit 2020 janë zgjidhur 22% më pak raste të veprave të rënda penale dhe 42% më pak raste të veprave penale të lehta (kundërvajtjes), në krahasim me vitin paraprak. Për këtë arsye, edhe koha në dispozicion për zgjidhjen e veprave të rënda penale është rritur për 64%, ndërsa edhe më shumë për veprat e kundërvajtjes.

Duhet të theksohet se rënia e efikasitetit të gjyqësorit vjen edhe si pasojë e mungesës së legjislacionit vendor që do të mundësonte mbajtjen e seancave dëgjimore përmes video konferencës. Kodi i Procedurës Penale nuk e autorizon mbajtjen e seancave dëgjimore përmes video konferencave, pavarësisht se plani emergjent i KGJK-së për përballje me pandeminë e lejon një gjë të tillë në rastet emergjente. Në këtë drejtim, gjykatat e kanë limituar përdorimin e video konferencave kryesisht në rastet civile, ndërsa kanë hezitur që të njëjtën teknologji ta përdorin edhe në rastet penale, nga frika e mungesës së pajisjeve të nevojshme teknologjike, cënimi i privatësisë dhe integriteti i sesioneve online.⁹

Nevoja për rritje të profesionalizmit dhe kompetencës¹⁰

Profesionalizmi dhe kompetenca janë parakushte për administrim të duhur të drejtësisë. Pavarësisht ofrimit të trajnimeve për vite me radhë nga Instituti Gjyqësor, dhe më pas Akademia e Drejtësisë e Kosovës (AD), profesionalizmi dhe kompetenca ende kanë nevojë të rriten.

Një ndër faktorët kryesor që shkakton pengesa në këtë drejtim, është se trajnimi i vazhdueshëm i gjyqtarëve dhe prokurorëve kryesisht mbetet në vullnetin e tyre. Ata duhet të ndjekin trajnim të vazhdueshëm, vetëm në rastet kur kanë vlerësim të ulët të performancës, që në praktikë nuk ka

⁹ Raporti Special i Misionit të Bashkimit Evropian për Sundimin e Ligjit (EULEX) për ndikimin e COVID-19 në Sundimin e Ligjit në Kosovë – Faktet (gjetjet dhe rekomandimet) – I qasshëm në: <https://www.eulex-kosovo.eu/?page=2,11,2392>

¹⁰ Shih gjithashtu dokumentet e politikave ‘Rritja e profesionalizmit dhe kompetencës së personelit gjyqësor dhe prokurorial’, 2019 dhe ‘Përmirësimi i profesionalizmit në luftën kundër krimit të organizuar dhe korrupsionit të nivelit të lartë’, 2019

ndodhur. Aspekti vullnetar i trajnimit të vazhdueshëm nuk e bën inkurajues ndjekjen e tij, që dëmton mundësitë për specializim dhe cilësinë e punës. Në fakt, trajnimet e shenjësuar dhe të koordinuara për nevojat reale, janë të pakta, si dhe ato ndër-disiplinore, për çështje si integriteti, shkrimi i vendimeve dhe arsyetimi i tyre, mendimi kritik dhe analizimi, tejkalimi i stresit dhe të tjera. Ka mangësi të theksuara gjithashtu në ndërlidhjen e vlerësimeve të performancës me nevojat për trajnim.

Faktor tjetër i rendësishëm është metoda klasike e ofrimit të trajnimeve. Ato zakonisht janë të disejnuara në stilin *ex-cathedra*, të organizimit të klasëve dhe prezencës fizike¹¹, me mundësi të limituara për ‘luajtjen e roleve’ ose rasteve studimore. Vlerësimi i trajnerëve bëhet, por është kryesisht formal, dhe po kaq formalisht bëhet edhe vlerësimi i të trajnuarve. Platforma elektronike e AD ende nuk është mjaftueshëm e zhvilluar, ashtu që të përdoret vazhdimisht për nevojat e gjyqtarëve dhe prokurorëve. Përfundimisht, faktori i tretë ka të bëjë me kriteret e mangëta për zgjedhjen e trajnerëve dhe mentorëve, që ndikon në cilësinë e trajnimeve. Policia, si pjesë e zbulimit dhe hetimit të veprave penale, ka gjithashtu kapacitetet e limituara. Ka nevojë tutje për trajnime të specializuara dhe të përbashkëta.

Si informatë shtesë, vlen të theksohet se gratë mbeten të nënpërfaqësuar në sistemin e drejtësisë.

Llogaridhënia e pamjaftueshme¹²

Në Kosovë deri tani është krijuar legjislacioni dhe sistemi për llogaridhënien e gjyqtarëve dhe prokurorëve. Kjo është bërë fillimisht përmes Pakos së Ligjeve të Gjyqësorit¹³ në vitin 2010, të cilat u reformuan më tej në vitet 2018, gjegjësisht 2019. Këto ligje dhe rregullat, si dhe masat tjera që rrjedhin nga to, kanë adresuar llogaridhënien, duke përcaktuar transparencën e funksionimit të sistemit dhe mundësitë e parashtrimit të ankesave për punën e gjyqtarëve dhe prokurorëve. Mirëpo, llogaridhënia ende nuk është në nivelin e duhur. Mungesa e sistemit adekuat të llogaridhënies është një nga shkaqet kryesore për uljen e motivimit për efikasitet në punë.

Dy faktorë kryesorë kanë krijuar llogaridhënie të pamjaftueshme. I pari është vlerësimi jo adekuat i performancës. Kjo përfshin si gjyqtarët dhe prokurorët individual, gjithashtu kryetarët e gjykatave dhe kryeprokurorët. Mekanizmat aktual për vlerësim nuk kanë dëshmuar të jenë efikase. Sistemi aktual nxjerr në shumicën e rasteve vlerësime të larta, që nuk përputhet me vonesat dhe shkeljet evidente që ndodhin gjatë administrimit të drejtësisë.

Faktori i dytë është transparenca e ulët dhe mungesa e komunikimit të duhur me publikun. Raportimi i të dy këshillave nuk është i karakterit analitik dhe shpesh nuk publikohet me kohë. Kjo vlen edhe për raportimin nga kryetarët e Gjykatave dhe Kryeprokurorët që është jo-konsistent. Publikimi dhe arsyetimi i vendimeve dhe informatave të caktuara mungon. Në përbërjen e këshillave ka kriteret kufizuese për anëtarësimin e personave jashtë sistemit. Veçanërisht, numri i

¹¹ Gjendja e shëndetit publik, si pasojë e COVID-19, e ka ndryshuar këtë fakt, ngase trajnimet më herët janë mbajtur kryesisht me prezencë fizike.

¹² Shih gjithashtu dokumentin e politikave ‘Rritja e llogaridhënies së sistemit gjyqësor dhe prokurorial’, 2019

¹³ Ligji për Këshillin Gjyqësor, Ligji për Këshillin Prokurorial, Ligji për Gjykatat dhe Ligji për Prokurorin e Shtetit

prokurorëve në KPK është mjaft i madh. Mbikëqyrja dhe llogaridhënia e rregullativës së nxjerrë nga këshillat është e mangët. Gjithashtu, qasja e publikut në seancat gjyqësore, informatat lidhur me rastet specifike dhe vendimet gjyqësore dhe ato prokuroriale, veçanërisht aktakuzat, janë shpesh problematike. Si ilustrim, shumica e seancave ende mbahen në zyrat e gjyqtarëve. Uebfaqet e institucioneve nuk janë të plota në të gjitha gjuhët zyrtare. Duket se bashkëpunimi dhe besimi i ndërsjellë në mes të institucioneve të sundimit të ligjit dhe shoqërisë civile ende është në faza fillestare.¹⁴

Sa i përket llogaridhënies, vlen gjithashtu të theksohet se Ligji për Përgjegjësinë Disiplinore¹⁵ është një ligj relativisht i ri dhe mund të konkludohet se i njëjti ende nuk ka prodhuar rezultatet e dëshiruara.

Sistemi i cenueshëm ndaj akterëve të jashtëm¹⁶

Cenueshmëria e sistemit gjyqësor dhe prokurorial, ndaj akterëve të jashtëm, qoftë në aspekt të organizatave apo individëve, mbetet problematike në Kosovë. Kjo nënkupton se integriteti mund të mungoj tek gjyqtarët dhe prokurorët e caktuar, që pastaj ndikon potencialisht në vendimet e tyre. Në Kosovë, me pakon e lartpërmendur të ligjeve, rregullave dhe masave zbatuese, është synuar që integriteti të jetë në nivel të duhur. Procedurat për të siguruar këtë janë konsiderueshëm të detajizuara, por problemet shfaqen kryesisht gjatë zbatimit, ngjashëm me fushat tjera. Gjithashtu vullneti dhe praktika institucionale kanë ndikuar në këtë aspekt. Të gjitha këto krijojnë nevojën për ndërhyrje të natyrës reformuese për të siguruar arritjen e rezultateve të synuara.

Por, për të bërë këtë ndërhyrje, duhet të kuptohen faktorët që cenojnë integritetin. Fillimisht, sistemi çalon në procedurat e rekrutimit. Ka mangësi në konfidencialitetin e procesit të testimit dhe intervistimit, kritere që nuk bazohen në vlerësimin e kompetencës dhe mungesë të transparencës dhe mjeteve juridike gjatë finalizimit të listës së rekomandimeve për emërim nga të dy këshillat. Baza e qartë mbi të cilën Presidenti mund të refuzoj emërimin ose ri-emërimin e një gjyqtari gjithashtu mungon.

Pastaj, sistemi i duhur i kontrollit të integritetit (*vetting*) mungon. Këtu është fjala për verifikimin fillestar dhe kontrollin e vazhdueshëm të integritetit, ku të dyja ballafaqohen me të meta të caktuara. Shërbyesit civil me kompetenca të verifikimit nuk i nënshtrohen verifikimit dhe kanë kapacitete të limituara. Objektivat për verifikim janë të paqarta dhe mungojnë procedurat ose udhëzimet se si verifikimi duhet të realizohet. Procesit në përgjithësi nuk është transparent për të kuptuar nëse dikush diskualifikohet për shkak të verifikimit. Pas emërimit, përveç procesit të deklarimit të pasurisë, gjyqtarët dhe prokurorët nuk i nënshtrohen verifikimit të përsëritur dhe të rregullt, që është një e metë e rëndësishme për qëllimin e sigurimit të integritetit.

¹⁴ Shih gjithashtu dokumentin e politikave 'Rritja e rolit mbikëqyrës dhe avokues të organizatave të shoqërisë civile', 2019

¹⁵ Ligji nr. 06/1 – 057 për Përgjegjësinë disiplinore të gjyqtarëve dhe prokurorëve. I qasshëm në: <https://gzk.rks-gov.net/ActDetail.aspx?ActID=18336>

¹⁶ Shih gjithashtu dokumentin e politikave 'Rritja e integritetit të sistemit gjyqësor dhe prokurorial', 2019

Integriteti gjithashtu ndikohet nga kapacitetet e limituara të menaxhimit dhe lidërshiptit në sistem. Në KGJK dhe KPK, edhe pse me bazë ligjore, emërohen në cilësinë e anëtarëve, gjyqtarë dhe prokurorë me përvojë modeste. Trajnimet për menaxhim dhe lidërshipt gjithashtu janë të mangëta, që vështirëson zhvillimin e këtyre aftësive për sigurimin e integritetit të vartësve të tyre dhe organizimin më efikas të punës.

Për funksionimin e sistemit është i rëndësishëm edhe integriteti i policisë. Gjithashtu sistemi tek policët mund të konsiderohet i cenueshëm. Ka mungesë të trajnimeve adekuate për integritet dhe etikë, si dhe nuk bëhet verifikimi i sigurisë për të gjithë pjesëtarët e policisë. Faktor tjetër për cenimin e integritetit është edhe mos-vendosja e kamerave në trup, që tani më zbatohet në disa vende të zhvilluara, por edhe mungesa e regjistrimit audio ose video të intervistimit. Për më shumë, deklarimi i pasurisë në kuadër të policisë, bëhet vetëm nga zyrtarët e lartë, dhe jo edhe nga ata të cilët mund të jenë në pozita të ndjeshme.¹⁷

3.2. Drejtësia penale

Veprat penale janë ndër fenomenet që pengojnë më së shumti zhvillimin e Kosovës. Për të i parandaluar ose zbuluar ato, duhen institucione me integritet, kapacitete dhe kompetenca të qarta. Institucione të tilla duhet të mundësojnë sanksionimin e përshtatshëm të kryerësve të veprave penale dhe të punojnë në mënyrë efektive për ri-integrimin e tyre në shoqëri dhe ndalimin e recidivizmit.

Në këtë drejtim, gjatë hulumtimit të bërë janë identifikuar probleme të theksuara të cilat pengojnë zbatimin e drejtësisë penale. Fokusi kryesor ka qenë në krimin e organizuar dhe korrupsionin, si dhe ekzekutimin e sanksioneve penale, si fusha prioritare në këtë drejtim.

Problemet në parandalimin dhe luftimin e krimit të organizuar dhe korrupsionit

Korniza institucionale për parandalimin dhe luftimin e krimit të organizuar dhe korrupsionit, mund të konsiderohet se, në përgjithësi, është në vend. Agjencia Kundër Korrupsionit është ndër institucionet kryesore në këtë aspekt. Veprat e ndërlidhura me këto fenomene janë të sanksionuara sipas Kodit Penal dhe procedura e përcaktuar në Kodin e Procedurës Penale ofron një bazë solide për ndjekjen e tyre me sukses. PSRK ka kompetencë ekskluzive në ndjekjen penale të krimit të organizuar dhe kompetencë plotësuese për rastet e korrupsionit të nivelit të lartë. Pavarësisht hapave të ndërmarrë, këto fenomene negative janë ende mjaft prezente në shoqërinë e Kosovës. Problematike janë parandalimi dhe luftimi i tyre, por edhe sanksionimi.

Aktualisht ë Kosovë është një numër i madh i institucioneve të përfshira drejtpërdrejt ose tërthorazi në luftën kundër korrupsionit, por është vështirë të identifikohet se ku çalon sistemi. Kjo është për arsye se ato nuk janë të integruara mirë në mes vete. Kompetencat e tyre nuk janë të qarta ose janë kundërthënëse, që rezulton në mungesën e pronësisë dhe lidërshiptit për agjendën reformuese në përgjithësi dhe adresimin e rasteve të caktuara, në veçanti. Procedurat dhe mekanizmat për


¹⁷ Shih gjithashtu dokumentin e politikave 'Integriteti i Policisë së Kosovës', 2019

bashkëpunim në mes tyre janë gjithashtu të mangëta, duke përfshirë edhe kapacitetet e limituara. Për parandalim, veçanërisht mungon monitorimi adekuat i Strategjisë Kombëtare Kundër Korrupsionit dhe mjete të rëndësishme për vlerësimin anti-korrupsion të legjislacionit, vlerësimin e rrezikut të korrupsionit, planet e Integritetit dhe kontrollimin e integritetit institucional.¹⁸

Deklarimi i pasurisë nga zyrtarët është gjithashtu një nga masat që duhet të siguroj parandalim, por edhe mundësoj zbulimin e veprave penale. Sistemi aktual i deklarimit ka mangësitë e tij. Këto shprehen së pari në konceptet përkufizuese, ku përkufizimet për zyrtarët nuk janë të harmonizuara si dhe mungon përkufizimi i dhuratës. Gjithashtu, formularët e deklarimit nuk janë të specializuar në bazë të gradave të ndryshme të zyrtarëve, dhe nuk bëhet vlerësim i pozitave më të ndjeshme ndaj rrezikut të korrupsionit, por detyrohen të deklarojnë pasurinë të gjithë zyrtarët e lartë në kuptimin gjenerik. Deklarimi i pronësisë përfituese nga aksionet nuk bëhet fare, që është një faktor tjetër i problemit. Verifikimi i deklarimeve gjithashtu ka të metat e saj, ku burime tjera të informacionit nuk merren parasysh në bazë të ligjit, si dhe mungon një standardizim i procesit të verifikimit si dhe bashkëpunimi me qeveritë tjera për të marrë informata për pasuritë e jashtëligjshme të mundshme, që gjenden jashtë vendit. Sanksionet për mos-deklarim ose raportim jo real janë vetëm penale, në kundërshtim me standardet evropiane.¹⁹

Pavarësisht të metave në parandalim, disa prej veprave të krimit të organizuar dhe korrupsionit të nivelit të lartë, edhe zbulohen. Por, fatkeqësisht, mesatarja e atyre që sanksionohen është mjaft e vogël, krahasuar me vendet e zhvilluara.²⁰

Tabela 3 – Mesatarja e ndjekjeve të suksesshme që përfundojnë me aktgjykim dënues



Kjo ndodh si rezultat i faktorëve të ndryshëm. I pari është ambiguiteti në interpretimin e dispozitave ligjore në mes të gjykatave dhe prokurorisë. Ekziston një mos-përputhje e rëndësishme, veçanërisht në përkufizimin e ‘dashjes’ së të pandehurve në shkeljet e pretenduara lidhur me veprat në fjalë, që i bën rastet të dështojnë para gjykatave.

Mangësitë procedurale për hetim adekuat të këtyre veprave janë faktori i dytë evident. Afati për hetim mund të konsiderohet i shkurtër në përgjithësi, por veçanërisht në rastet më të ndërlikuara,

¹⁸ Shih gjithashtu dokumentin e politikave ‘Përmirësimi i kornizës institucionale kundër korrupsionit’, 2019

¹⁹ Shih gjithashtu dokumentin e politikave ‘Përmirësimi i sistemit për deklarimin e pasurisë dhe rregullorëve për pranimin e dhuratave’, 2019

²⁰ Shih gjithashtu dokumentet e politikave ‘Vlerësimi i luftës kundër krimit të organizuar dhe korrupsionit të nivelit të lartë. 2019 dhe ‘Përmirësimi i profesionalizmit në luftën kundër krimit të organizuar dhe korrupsionit të nivelit të lartë’, 2019

veçanërisht duke marr parasysh se veprimet hetimore pezullohen, ndërsa afati i përgjithshëm jo, në rast të përfshirjes së elementit të bashkëpunimit juridik ndërkombëtare në to. Në anën tjetër, standardi për fillimin e hetimit është shumë i ulët, që në disa raste cenon të drejtat e njeriut pa bazë, meqë hetimet mund të zgjasin. Në përgjithësi, kapacitetet për hetime janë të kufizuara nga numri i limituar i zyrtarëve policorë me ekspertizë dhe prokurorëve dhe gjyqtarëve me specializim të nevojshëm për të kuptuar veçanërisht rastet e ndërlikuara.

Konfiskimi i pasurisë së përdorur për të kryer ose që derivon nga veprat penale mbetet gjithashtu sfidë kyçe. Pavarësisht, që një pjesë e caktuar e pasurisë së tillë sekuestrohet në mënyrë të suksesshme, ajo kryesisht nuk konfiskohet me vendim përfundimtar të gjykatave. Për ilustrim, në vitin 2018, vetëm 1% e pasurisë së sekuestruar ka përfunduar me konfiskim, që është alarmante.

Sa i përket hetimit të veprave penale në përgjithësi, vlen të theksohen edhe kapacitetet e limituara të Policisë. Ndërlidhja e bazës së tyre të të dhënave me atë të gjyqësorit dhe prokurorisë nuk është bërë plotësisht. Gjithashtu është e paqartë se si duhet të krijohen ekipet e përbashkëta hetimore, brenda policisë, por edhe ato ndërkombëtare.

Problemet në ekzekutimin e sanksioneve penale²¹


Mënyra e sanksionimit të kryerësve të veprave penale dhe ekzekutimi i këtyre sanksioneve është i rëndësishëm primare për zvogëlimin e kriminalitetit. Synimi duhet të jetë gjithmonë rehabilitimi dhe ri-integrimi i të dënuarve në shoqëri, por edhe parandalimi dhe mbrojtja e publikut.

Kodi Penal i Kosovës është akti kryesor me të cilin sanksionohen veprat penale dhe përcaktohen llojet dhe llogaritja e sanksioneve. Ligji për Ekzekutimin e Sanksioneve Penale, përcakton mënyrën e ekzekutimit, ku SHKK dhe SHSK janë dy agjencitë kryesore qeveritare në këtë drejtim. Që nga themelimi i këtyre dy agjencive qeveritare, pas luftës, kapacitetet e tyre kanë përparuar dukshëm. Viteve të fundit katër qendra të reja korrektuese kanë filluar aktivitetin, duke rritur numrin e institucioneve për ekzekutimin e sanksioneve penale në gjithsej njëmbëdhjetë. Pavarësisht, këtij progresi, faktorë të ndryshëm të natyrës ligjore dhe zbatuese, pengojnë arritjen e qëllimit legjitim të sanksioneve penale.

Sa i përket mënyrës së shqiptimit të sanksioneve, preferencë e madhe ende i jepet sanksionit të burgosjes, përfshirë edhe paraburgosjen që ka një ndikim buxhetor të lartë. Mund të thuhet se dënimi me burgim nuk zbatohet si alternativë e fundit, siç përcaktohet me standardet evropiane. Në anën tjetër, numri i sanksioneve dhe masave alternative që shqiptohen nga Gjykatat është shumë i ulët, rreth 3.1%. Ato kryesisht urdhërohen për të miturit.

²¹ Shih gjithashtu dokumentin e politikave 'Përmirësimi i ekzekutimit të sanksioneve penale', 2019

Tabela 4 – Llojet e sanksioneve penale të shqiptuara në vitin 2018²²



Vendimet e gjykatës ndikohen edhe nga mungesa e raportit të para-ndëshkimit, të cilin nuk e bën SHSK, por edhe udhëzimeve më specifike për matjen e dënimit. Një e metë e rëndësishme e sanksioneve alternative është se legjislacioni relevant nuk ofron detaje në lidhje me përmbajtjen e sanksioneve alternative dhe detyrimet, si dhe të drejtat e shkelësit. Kjo vlen edhe për sanksionet tjera, të cilat nuk janë të harmonizuara plotësisht me ato të BE-së. Vlen të theksohet gjithashtu se të sanksionuarit me gjobë, nuk regjistrohen në evidencën e të dhënave penale, e cila duhet të zhvillohet tutje dhe të mundësoj komunikim më të lehtë me bazat e tjera të të dhënave.

Pastaj, sa i përket ekzekutimit të sanksioneve, fillimisht katër qendrat e reja nuk shfrytëzohen sa duhen, ndërsa të gjitha qendrat e vjetra ende përdoren, pavarësisht se disa prej tyre nuk kanë kushte të përshtatshme. Në disa prej tyre ka më shumë staf, se sa të burgosur. Kjo nënkupton se aftësitë e planifikimit strategjik dhe veçanërisht ato për menaxhimin e burimeve njerëzore çalojnë tek SHKK. Në SHKK ka gjithashtu një numër të ulët të stafit të gjinisë femërore. Tutje, vlerësimi i rrezikut dhe nevojave për të bërë planifikim individual për secilin të burgosur, mungon. Aktivitetet për të burgosurit, si puna, mësimi dhe programet rehabilituese, nuk i arrijnë më shumë se gjysmën e të burgosurve. Në anën tjetër, sa i përket SHSK-së monitorimi elektronik nuk zbatohet dhe ligjërisht nuk mbulon të gjitha sanksionet e mundshme. SHSK gjithashtu ka kapacitete të limituara për planifikim strategjik dhe në përgjithësi bashkëpunimi me SHKK ka nevojë të rritet edhe më shumë.

²² Lëndët penale të disponueshme në Departamentin e Përgjithshëm dhe Departamentin e Krimeve të Rënda.

3.3. Qasja në drejtësi

Drejtësia ofrohet nga institucionet e sistemit gjyqësor si dhe ato që ofrojnë shërbime ligjore, profesionet e lira dhe Ministria e Drejtësisë si institucioni kryesor i politikëbërjes. Këto mekanizma, si çdo shërbim tjetër publik, duhet të jenë në shërbim të shoqërisë. Të gjithë individëve, përfshirë ata nga grupet e cenueshme, duhet tu mundësohet qasje adekuatë në to, në mënyrë që zëri i tyre të dëgjohej, të ushtrojnë të drejtat e tyre dhe t'i mbajnë mekanizmat përgjegjëse, ngase ato funksionojnë në bazë të tatimeve të tyre. Në vijim, do të prezantohet gjendja aktuale me qasjen në gjykata dhe prokurori, si dhe ofrimin e shërbimeve ligjore, jashtë gjyqësorit.

*Problemet lidhur me qasjen në gjykata dhe prokurori*²³

Deri tani, institucionet e Kosovës kanë ndërmarrë hapa të rëndësishëm për të siguruar qasjen në gjykata dhe prokurori. Kjo vërehet veçanërisht sa i përket legjislacionit i cili është në masë të konsiderueshme në përputhje me standardet evropiane. Kushtetuta dhe legjislacioni sektorial parashohin ofrimin e të drejtës në përkthim, në informim, në ndihmë juridike gjatë procedurave gjyqësore, dhe për parashtrimin e mjeteve juridike ndaj vendimeve administrative dhe gjyqësore. Pavarësisht kësaj, në disa fusha ose për disa kategori qasja bëhet më e vështirë, kryesisht për shkak të faktorëve të zbatimit jo të duhur të legjislacionit.

Janë disa aspekte që vlen të veçohen për qasjen në drejtësi. Së pari, ajo mbetet sfiduese për grupet më të cenuara të shoqërisë, si gratë, fëmijët, personat e moshuar, personat me aftësi të kufizuara, komuniteti LGBTI dhe komunitetet etnike pakicë. Kjo është rezultat i faktorëve të mungesës së mjeteve financiare, informimit, pozitës shoqërore, mungesës së infrastrukturës dhe nivelit të ulët të besimit në sistem. Dhuna në familje mbetet në nivele të larta dhe administrimi i drejtësisë në këtë drejtim, nuk është ende në nivelin e kënaqshëm. Vlen të theksohet se për shkak të, ndër të tjera, besimit të ulët në institucione dhe stigmës së përhapur, dhuna në familje mbetet shumë e nënraportuar.

Së dyti, ofrimi i ndihmës juridike, dhe sidomos asaj falas, mbetet sfidues. Një pjesë të konsiderueshme të personave në nevojë nuk ju ofrohet kjo ndihmë, veçanërisht në procedurë penale, ose ajo është e cilësisë së dobët. Kjo situatë më së shumti i prek grupet më të cenueshme, përfshirë gratë, fëmijët, viktimat e dhunës në familje dhe viktimat e dhunës seksuale. Kjo vjen nga faktorë të ndryshëm, siç janë buxheti dhe kapacitetet e kufizuara të ANJF-së për të mbuluar tërë territorin e Kosovës, mos-definimi i qartë i 'interesit të drejtësisë' kur duhet të sigurohet mbrojtja falas sipas ligjit, mungesa e mekanizmit të licensimit të OJQ-ve dhe faktorë të tjerë. Qasja në avokat shpesh ofrohet vetëm pas marrjes në pyetje nga policia dhe veçanërisht jo për personat dëshmitar të cilat janë të ndaluar në polici.

Së treti, organizimi i sistemit gjyqësor dhe infrastruktura e dobët janë pengesë për qasje në drejtësi. Drejtësia administrative është problematikë prioritare. Fakti se vetëm një Departament i

²³ Shih gjithashtu dokumentet e politikave 'Përmirësimi i qasjes në gjykata dhe prokurori', 2019 dhe 'Përmirësimi i efektivitetit të mjeteve juridike', 2019

centralizuar, në kuadër të Gjykatës Themelore në Prishtinë është kompetent për të gjitha kontestet administrative, e bën në parim qasjen në drejtësi më të vështirë. Kësaj duhet shtuar faktin se ky Departament nuk i vendos kontestet ‘në meritë’, duke i kthyer rastet për rishqyrtim tek organet administrative, që rezultojnë në mos-ofrim të drejtësisë për palët. Mungesa e procedurave ligjore për kërkesat e vlerës së vogël, siç parashihet nga e drejta e BE-së, është tjetër pengesë. Në gjykata të caktuara mungojnë sallat e gjykimit dhe pajisjet e nevojshme.

Së katërti, e drejta për interpretim e përkthim dhe e drejta për informim mbeten një sfidë tjetër e rëndësishme e qasjes në drejtësi. Ka diskrecion të theksuar në përcaktimin se kur dhe kush ka nevojë për interpretim dhe përkthim në procedurë si dhe mungojnë mjetet juridike për të sfiduar një vendim të tillë. Cilësia mbetet ende e pakënaqshme. Në rreth 61% të lëndëve, sipas një raporti, përkthimi nuk është siguruar ose ka qenë i cilësisë jo të duhur. Palët gjithashtu e kanë të vështirë të marrin informata për të drejtat dhe procedurën e tyre gjyqësore për shkak të, ndër të tjera, mangësive procedurale dhe mungesës së vullnetit për përdorimin e teknologjisë moderne të komunikimit. Modelet e procedurave të ndryshme gjyqësore janë më të fokusuar tek pjesëtarët e sistemit dhe jo qytetarët e qytetaret. Andaj, ata pa avokat/e, e kanë të vështirë të parashohin dhe kuptojnë procedurën, në mënyrë që të mbrojnë të drejtat e tyre.

Së pesti, shpenzimet gjyqësore janë pengesa tjetër për qasjen në drejtësi. Në disa procedura, si ajo e kontestit administrativ, palët janë të detyruara t’i ndajnë shpenzimet në pjesë të barabarta, që është jo-adekuate për personat që kanë pësuar dëm.

Përfundimisht, sa i përket mjeteve juridike, siç u cek më lartë numri i lëndëve të pazgjidhura është mjaft i madh si dhe vonesat procedurale janë të shumta, andaj është vërejtur se palëve ju mungon një mjet efektiv juridik për përshpejtimin e procedurave, në rastet e vonesave të konsiderueshme për zgjidhjen e rasteve të tyre, si dhe mundësia e kompensimit për vonesat e tilla. Sa i përket mjeteve tjera specifike, vërehet mungesa e mjetit juridik për viktimat, ndaj vendimeve të prokurorit lidhur me fillimin ose pushimin e hetimeve. Është gjithashtu e metë se këto vendime nuk arsyetohen mjaftueshëm nga prokurorët. Vlen gjithashtu të theksohet se mjetet juridike efektive, mbesin sfiduese posaçërisht në institucione të caktuara të ekzekutimit të sanksioneve penale. Për më shumë, mjetet juridike për të siguruar kompensimin për dëmet e shkaktuara nga organet administrative por edhe në rastet e privimit të kundërligjshëm nga liria, kanë mangësitë e tyre.

Problemet lidhur me ofrimin e shërbimeve ligjore²⁴

Në Kosovë, gjatë dhjetë viteve të fundit, janë krijuar një sërë profesioneve të lira, me kompetencë për ofrimin e drejtësisë. Përveç profesionit të avokatit/es, që është i natyrës klasike, profesionet e lira më të reja në Kosovë, përfshijnë noterët/et, ndërmjetësuesit/et, përmbaruesit/et privat/e dhe administratorët/et falimentues/e.

Deri tani, disa prej profesioneve të lira janë konsoliduar në mënyrë të konsiderueshme, ndërsa të tjerat janë ende në faza të hershme të zhvillimit dhe kanë nevojë për mbështetje të mëtutjeshme.

²⁴ Shih gjithashtu dokumentin e politikave ‘Përmirësimi i ofrimit të shërbimeve të profesioneve të lira’, 2019

Odat e këtyre profesioneve të lira, veçanërisht ajo e ndërmjetësuesve, përmbauesve privat dhe administratorëve falimentues, nuk janë ende plotësisht funksionale për të ngritur edhe cilësinë e këtyre profesioneve.

Cilësia e shërbimeve në përgjithësi mbetet si nevojë për tu rritur në vazhdimësi. Kjo është për shkak se trajnimet dhe mundësitë për specializim janë të limituara dhe kryesisht të mbështetura nga donatorë, ndërsa në disa raste, si tek avokatët që qëndrojnë shumë më mirë në edukimin e vazhdueshëm ligjor, mungojnë trajnime për shkathtësi. Standardet e etikës nuk janë ende në nivelin e duhur, në përgjithësi. Ka ankesa gjithashtu për zbatim të tarifave të jashtëligjshme. Tek noterët, në veçanti, ekziston një numër i fushave ku jo të gjithë noterët e kanë të unifikuar qasjen e tyre.

Mbikëqyrja e performancës mbetet sfidë e rëndësishme gjithashtu. Kapacitetet e MD-së në këtë drejtim janë të limituara dhe ata, sipas legjislacionit, nuk kanë kompetencë për mbikëqyrje të administratorëve falimentues. Edhe Odat kanë gjithashtu kapacitete dhe mundësi të limituara për trajnimin e stafit të përfshirë në mbikëqyrje.

Vetëdija mbetet e ulët për përdorimin e shërbimeve që ofrohen nga profesionet e lira. Përdorimi i mundësive të ndërmjetësimit dhe zbatimi i procedurave të falimentimit, përmes administratorëve falimentues, mbetet veçanërisht i ulët. Kjo zbatohet jo vetëm për përdoruesit potencial të tyre, por edhe hisedarët e tjerë, siç janë gjyqtarët, prokurorët, avokatët dhe organet administrative, të cilët mund të rekomandojnë shërbimet që ofrohen nga profesionet e lira.

Roli i Ministrisë së Drejtësisë²⁵

MD, së bashku me KGJK-në dhe KPK-në, janë institucionet kryesore të politikëbërjes për fushën e sektorit të sundimit të ligjit. MD është përgjegjëse për koordinimin strategjik të adresimit të problemeve të identifikuara në këtë sektor, përmes analizave të ndryshme të politikave, propozimit të legjislacionit primar dhe miratimit të legjislacionit sekondar, monitorimit të zbatimit të legjislacionit dhe masave të tjera. Kjo vjen në shprehje veçanërisht edhe në raport me procesin e anëtarësimit në BE, që kërkon ndërmarrjen e reformave të rëndësishme në zbatimin e standardeve të BE-së, veçanërisht nga Kapitulli 23 dhe 24 i *acquis*.

Organizimi aktual dhe kapacitetet e MD-së për të ndërmarrë hapa të koordinimit strategjik, përballen me disa sfida. Së pari, qasja strategjike është e fragmentuar me plane specifike strategjike, në dallim prej strategjisë gjithëpërfshirëse dhe kompetencat e MD-së nuk janë të plota, duke i munguar ato për ndihmën juridike falas, mbështetjen e viktimave dhe dëshmitarëve, dhe të tjera. Tutje, MD nuk përcjell në mënyrë të rregullt, për nevoja të saj, punën dhe funksionimin e gjyqësorit, me qëllim për të mbledhur statistikën dhe për të bërë analiza, që do të ishte në shërbim të politikëbërjes së informuar. Kapacitetet e departamenteve kyçe janë të limituara, veçmas sa i përket njohurive për detyrimet që rrjedhin gjatë procesit të anëtarësimit në BE dhe lobimit në këtë proces, në fushën e drejtësisë.

²⁵ Shih gjithashtu dokumentin e politikave 'Roli i Ministrisë së Drejtësisë në procesin e anëtarësimit në BE', 2019

4.0. VIZIONI DHE OBJEKTIVAT E STRATEGJISË PËR SUNDIMIN TË LIGJIT

Vizioni i procesit të Rishikimit FunkSIONAL për Sektorin e Sundimit të Ligjit është rikthimi i besimit të qytetarëve në drejtësi, sistem gjyqësor e prokurorial.

Siç është diskutuar më sipër, është gjetur se ky besim është zbehur si rezultat i sfidave në pavarësinë, llogaridhënien, efikasitetin, profesionalizmin dhe integritetin e sistemit gjyqësor e prokurorial, shoqëruar me qasje të dobësuar në drejtësi. Si rezultat i kësaj, por edhe të metave të ngjashme të identifikuara në institucionet përtej gjyqësorit dhe prokurorisë, lufta kundër korrupsionit, krimit të organizuar dhe shpërlarjes së parasë deri tani ka prodhuar rezultate jo të kënaqshme. Të gjitha këto sfidojnë arritjen e objektivës gjithpërfshirëse strategjike dhe prandaj hapat që duhen të ndërmerren drejt arritjes së saj kërkojnë që të jenë po kaq gjithpërfshirës. Kjo objektivë qëndrore strategjike synohet që të arrihet përmes arritjes së katër objektivave strategjike të cilat janë të orientuara drejt saj. E para, fuqizimi i sistemit gjyqësor dhe prokurorial të Republikës së Kosovës (5.1.); e dyta, fuqizimi i drejtësisë penale (5.2.); e treta, fuqizimi i qasjes në drejtësi (5.3); dhe, e katërta, fuqizimi i luftës anti-korrupsion (5.4.).

4.1. Fuqizimi i sistemit Gjyqësor dhe Prokurorial

Para se të elaborohen të gjitha këto objektiva, vlen të theksohet se gjatë Procesit të Rishikimit FunkSIONAL, një pjesë e caktuar e rekomandimeve që kanë derivuar nga dokumentet e politikave të përmendura në Kapitullin 2, qoftë për hartimin e ligjeve të caktuara, akteve nën-ligjore ose masave zbatuese tanimë kanë filluar të zbatohen nga Qeveria e Kosovës, KGJK, KPK, por edhe institucionet tjera të parapara për zbatim.

Masat e përzgjedhura në kuadër të objektivës për fuqizimin e sistemit gjyqësor dhe prokurorial synojnë që të shënjestrojnë ndërtimin e besimit të qytetarëve në drejtësi duke intervenuar në adresimin e katër elementeve kryesore në këtë drejtim: ngritjen e llogaridhënies së gjyqtarëve dhe prokurorëve (5.1.1), ngritjen e efikasitetit të sistemit gjyqësor e prokurorial (5.1.2), rritjen e profesionalizmit (5.1.3) dhe integritetit të gjyqtarëve e prokurorëve (5.1.4).

	Objektivi strategjik 1	Objektivat specifike	
1	Fuqizimi i sistemit Gjyqësor dhe Prokurorial	5.1.1	Ngritja e llogaridhënies së gjyqtarëve dhe prokurorëve
		5.1.2	Ngritja e efikasitetit e sistemit gjyqësor e prokurorial
		5.1.3	Rritja e profesionalizmit
		5.1.4	Rritja e integritetit të gjyqtarëve e prokurorëve

Intervenimet e parapara në kuadër të objektivës specifike për ngritjen e llogaridhënies, synojnë që të arrijnë dhe ngrisin nivelin e përgjegjësisë që gjyqtarët, prokurorët dhe personeli mbështetës i

japin qytetarëve/eve për të cilët shërbejnë, institucioneve mbikqyrëse dhe publikut në përgjithësi. Objektiva specifike për ngritjen e efikasitetit të sistemit gjyqësor dhe prokurorial synon që përmes masave të propozuara të ngrisë shpejtësinë dhe efektivitetin e proceseve gjyqësore e procedurave të udhëhequra nga prokuroritë, në mënyrë që drejtësia të ndahet më shpejtë dhe drejtë.

Përmes ngritjes së profesionalizmit dhe kompetencës së gjyqtarëve, prokurorëve dhe stafit mbështetës synohet që të rritet cilësia e vendimmarrjes dhe ndarjes së drejtësisë, duke shënjestruar ngritjen e kapaciteteve drejt kryerjes së detyrave të tyre. Ndërkaq, objektiva për ndërtimin e integritetit të gjyqtarëve, prokurorëve dhe stafit mbështetës synohet që të arrihet përmes intervenimeve të shënjestruara në reformimin e sistemit të rekrutimit, avancimit, verifikimit dhe vetingut.

4.1.1. Ngritja e llogaridhënies së sistemit gjyqësor dhe prokurorial

Kjo objektive specifike fokusohet në rritjen e përgjegjësisë së sistemit gjyqësor dhe prokurorial si brenda ashtu edhe jashtë sistemit. Një sistem llogaridhënës garanton përgjegjësi individuale të profesionistëve brenda vet sistemit gjyqësor apo prokurorial, përmes garantimit të transparencës në punë dhe mekanizmave meritore e kualitative të avancimit dhe disiplinimit eventual të tyre. Njëkohësisht, ky sistem llogaridhënës garanton mbrojtjen dhe lirinë e gjyqtarëve dhe prokurorëve në kryerjen e detyrave të tyre, por edhe përgjegjësinë e vetë sistemit drejt qytetarëve dhe qytetareve.

Kjo objektive specifike synohet të arrihet përmes zbatimit të masave të parapara, duke filluar me ndryshime ligjore në përbërjen e KGJK-së dhe KPK-së. Tutje, masat e planifikuara për reformimin e sistemit të raportimit dhe matjes së performancës së gjyqtarëve dhe prokurorëve, do të ngrisin nivelin e llogaridhënies duke përkushtuar vëmendje në kriteret kualitative të performancës, për dallim nga kriteret kuantitative. Për të lehtësuar ushtrimin më efektiv të mandatit të gjyqtarëve dhe prokurorëve, planifikohet që të harmonizohen dispozitat për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve, duke përfshirë elementet thelbësore që çojnë në shkarkimin e tyre, si dhe të futet kontrolli mbi vendimin e prokurorëve për të pushuar ndjekjen penale. Gjithashtu, llogaridhënia pritet të ngritet përmes ndërtimit të mekanizmave më të sofistikuar për informimin e publikut, duke përfshirë këtu procedura për trajtimin e kërkesave për qasje në dokumente publike, si dhe mbikqyrjen e zbatimit të Kodit të Etikës.

Me zbatimin e masave të parapara për këtë objektive specifike, pritet që të ndërtohet një sistem i përmirësuar i kontroleve dhe balanceve, të ngritet transparenca për punën e KGJK-së, KPK-së, vlerësime transparente dhe të besueshme të performancës së gjyqtarëve dhe prokurorëve, një proces i avancimit të gjyqtarëve dhe prokurorëve i bazuar në merita, i bazuar në kritere cilësore dhe tregues të qartë, rritje të transparencës së sistemit gjyqësor ndaj qytetarëve/eve që ju shërbejnë por edhe publikut në përgjithësi, pavarësi e përmirësuar e gjyqësorit dhe prokurorisë, zbatim konsistent i legjislacionit, dhe rrugë e mundësi të zgjëruara dhe të qarta të bashkëpunimit midis

organizatave të shoqërisë civile, shoqatave, odave dhe akademisë për bashkëpunim me sektorin e drejtësisë, duke lejuar gjithashtu një mbikëqyrje të rritur nga akterët e jashtëm.

4.1.2. Ngritja e efikasitetit të sistemit gjyqësor dhe prokurorial

Objektiva specifike për ngritjen e efikasitetit synon që të rrisë shpejtësinë dhe të përmirësojë mbarëvajtjen e zgjidhjes së lëndëve nga gjykatat, si dhe ndjekjen e tyre në mënyrë efikase nga prokuroria. Përveç shpejtësisë, përmes kësaj objektivë shënjestrohen edhe lëndët e grumbulluara në gjykata, akordimi i burimeve njerëzore me ngarkesën e lëndëve në gjykata, departamente e prokurori të caktuara, fenomeni i shtyerjes së seancave gjyqësore dhe shkalla e ulët e përdorimit të mjeteve alternative për zgjidhje të mosmarrëveshjeve. Në mënyrë që të rritet efikasiteti i gjithë sektorit të sundimit të ligjit do të bëhen përpjekje të mëtejshme në digjitalizimin dhe përdorimin e teknologjisë moderne në sektor.

Si rrjedhojë, kjo objektivë synon ndërtimin e një sistemi i cili trajton çështjet brenda një kohe të arsyeshme, me procedura të qarta dhe të parashikueshme, i cili pamundëson grumbullimin e lëndëve në gjykata e prokurori. Zgjidhjet e ofruara për të arritur objektivën e ngritjes së efikasitetit janë: akordimi i mirëfillitë i burimeve në raport me ngarkesën e lëndëve në gjykata dhe prokurori, qartësimi i procedurave të brendshme të punës së gjykatave dhe prokurorive, përdorimi i duhur i SMIL dhe i vazhdueshëm i sistemit qendror të regjistrimit penal, krijimi i kushteve për trajtimin e lëndëve përbrenda një periudhe të arsyeshme dhe zgjidhja e lëndëve të vjetra bazuar në parimin e prioritetit dhe, e fundit, përdorimi i ZAK në zgjidhjen e lëndëve civile dhe penale.

Duke qenë se Gjykata Themelore në Prishtinë bartë barrën kryesore të lëndëve të të gjitha sferave, duke përfshirë këtu edhe lëndët e natyrës ekonomike, Strategjia synon hartimin e një plani të veçantë për këtë gjykatë. Ky plan do të mundësojë përrputhjen e burimeve njerëzore me ngarkesën e lëndëve nga kjo gjykatë, si dhe qasje më të shënjestruar drejt nevojave specifike të kësaj gjykate në hartim të politikave rigoroze të transparencës dhe trajnimeve të specializuara.

Ndryshim qenësor që propozohet këtu është krijimi i Gjykatës Komerciale, si një gjykatë e vetme, e specializuar me kompetencë për të zgjidhur të gjitha lëndët që ndërlidhen me bizneset. Krijimi i kësaj gjykate si adresë e vetme e bizneseve dhe investitorëve të huaj, do të mundësojë zhblokimin aktual të zgjidhjes së lëndëve të kësaj natyre dhe eliminimin e konfliktit të kompetencave të natyrës komerciale e administrative. Përmes Ligjit për Gjykatën Komerciale, gjykata do të ketë burimet dhe menaxhim të dedikuar, gjyqtarë të specializuar në të dy nivelet, procedura të veçanta për menaxhim të lëndëve në përrputhje me SMIL, duke çuar kështu në zgjidhje më të shpejtë dhe profesionale të lëndëve.

Përmes masës për qartësimin e procedurave të brendshme, pritet që të përmirësohen procedurat e caktimit dhe prioritizimit të lëndëve, trajtimit të lëndëve joaktive dhe në përgjithësi menaxhimi i rrjedhës së lëndëve. Futja e caktimit automatik të lëndëve, zbatimi i obligueshëm i CEPEJ për menaxhim të kohës si dhe ndërmarrja e masave ndëshkuese ndaj palëve për mungesë në seanca janë disa nga masat e propozuara këtu. Përdorimi i parimit FIFO (first one in - first one out;

pranohet e para – trajtohet e para), do të mundësojë aktivizimin dhe zgjidhjen e lëndëve më të vjetra. Për më tepër, ndërtimi i një sistemi më të mirë për raportim në KGJK dhe KPK, do të mundësojë mbledhje më të mirë dhe të besueshme të të dhënave dhe në fund, analizë dhe përdorim të tyre për zhvillimin e duhur të politikave.

Stimulimi i përdorimit të mekanizmave alternative për zgjidhje të mosmarrëveshjeve (ZAK), siç janë arbitrazhi (për çështjet civile) dhe ndërmjetësimi (çështje civile dhe penale) do të ndikojë dukshëm në uljen e numrit të lëndëve të nevojshme që zgjidhen nga gjykatat. Në kuadër të kësaj, propozohen investimet në kompletimin e kornizës sekondare ligjore dhe infrastrukturore për të mundësuar referimin e rasteve në ndërmjetësim, si dhe nxitja e përdorimit të arbitrazhit nga bizneset.

Me zbatimin e këtyre masave pritet që të lehtësohet ngarkesa e gjykatave me lëndë dhe të krijohet një sistem që zgjidhë lëndët brenda një afati të arsyeshëm, fuqizon ekonominë duke mundësuar zgjidhje efikase të lëndëve ekonomike, dhe pamundëson grumbullimin dhe vjetërsimin e lëndëve.

4.1.3. Ngritja e profesionalizmit dhe kompetencës së personelit gjyqësor dhe prokurorial

Objektiva mbi ngritjen e profesionalizmit dhe kompetencës synon ngritjen e cilësisë së vënies së drejtësisë, duke investuar në kapacitetet profesionale të gjyqtarëve, prokurorëve dhe strafit mbështetës. Ngritja e profesionalizmit të këtyre funksionarëve do të ndikojë në vendimmarrje më të qartë, transparente dhe të qëndrueshme, e cila ndikon drejtëpërdrejt në perceptim më pozitiv të sistemit të drejtësisë.

Kjo objektivë orientohet drejt ndërtimit të një strukture të qëndrueshme institucionale dhe një kornize ligjore për zhvillim profesional, si masë e parë. Në kuadër të kësaj mase, planifikohet miratimi i një ligji të veçantë për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve, i cili do të unifikonte dhe qartësonte dispozitat mbi statusin, instrumentet dhe mundësitë për zhvillim në karrierë, dhe përgjegjësitë specifike të institucioneve karrshi këtyre profesionistëve.

Si masë e dytë, planifikohet përshtatja e programeve të tranimit profesional me nevojat specifike të sektorit dhe të profesionistëve specifikë. Kjo do të mundësohej përmes përdorimit të të dhënave nga vlersimet e performancës, duke identifikuar kështu mangësitë profesionale, reformimit dhe rishikimit të vazhdueshëm të kurrikulave nga Akademia e Drejtësisë, dhe bashkëpunimit të KGJK-së, KPK-së dhe Akademisë në hartimin e kurrikulave moderne.

Në kuadër të masës së tretë, fokus të veçantë gëzon Akademia e Drejtësisë dhe kapacitetet e saj për t'i shërbyer nevojave të sektorit të drejtësisë. Kështu, planifikohet akordimi i buxhetit dhe një sërë masash të tjera për të mundësuar strukturë të qëndrueshme të Akademisë.

Si rezultat i këtyre masave, pritet që të qartësohet statusi dhe mundësitë për zhvillim profesional të gjyqtarëve dhe prokurorëve, duke garantuar kështu mbrojtjen e tyre ligjore dhe institucionale, si dhe të fuqizohet Akademia e Drejtësisë në ofrimin e shërbimeve cilësore të trajnimit e cila i

përgjigjet nevojave të sektorit të drejtësisë. Kjo mundëson që trajnimet profesionale të përkthehen në rritje të prekshme të cilësisë në vënie e drejtësisë.

4.1.4. Rritja e integritetit të sistemit gjyqësor dhe prokurorial

Objektiva e katërt specifike synon ndërtimin e një sistemi gjyqësor e prokurorial të përbërë nga profesionistë me integritet të lartë moral dhe profesional, të cilët rekrutohen dhe avancohen përmes një sistemi të qëndrueshëm e të bazuar në merita, dhe të cilët dëshmojnë këtë integritet gjatë gjithë shërbimit të tyre në detyrë.

Masa e parë në kuadër të kësaj objektive fokusohet në ndërtimin e një KGJK dhe KPK të qëndrueshme, që ruajnë integritetin. Në kuadër të saj, planifikohen rishikimi i kriterëve në atë mënyrë që të mundësohet vetëm pjesëmarrja e gjyqtarëve dhe prokurorëve me mandat të përhershëm dhe me më shumë përvojë, rishikimi i kriterëve për pjesëmarrjen e anëtarëve jo-gjyqtarë dhe jo-prokurorë, si dhe stimulimi i pjesëmarrjes së profesionistëve të tjerë të së drejtës.

Propozimi tjetër fokusohet në ndërtimin e një sistemi të rekrutimit, transferimit dhe avacimit të gjyqtarëve dhe prokurorëve, të bazuar në kompetencë. Kjo do të reformojë mënyrën e testimit dhe intervistimit në atë mënyrë që të nënvizohen aftësitë profesionale dhe praktike të profesionistëve në rekrutim. Gjithashtu, planifikohet rishikimi i mjeteve juridike në dispozicionin të kandidatëve të pasuksesshëm. Përmes masave që reformojnë matjen e performancës dhe fokusin në tregues kualitativ, synohet transferi dhe avancimi i gjyqtarëve dhe prokurorëve bazuar vetëm në merita dhe profesionalizëm.

Sistemi aktual i verifikimit të gjyqtarëve dhe prokurorëve ka një listë të gjatë të mangësive, në mesin e të cilave veçohet kryerja e verifikimit vetëm në momentin e rekrutimit dhe gama tejet e ngushtë e informatave që mblidhen në kuadër të këtij procesi. Prandaj, masa kryesore në kuadër të kësaj objektive specifike planifikon ndërtimin e një sistemi të pavarur që kryen kontrollë të vazhdueshme dhe të rregullta të integritetit të gjyqtarëve dhe prokurorëve, të njohur ndryshe si “vetting”, në përputhje edhe me Koncept Dokumentin që është duke u zhvilluar për këtë çështje. Ky sistem do të përfshijë gjithë spektrin e kontrollit efektiv të integritetit. Në aspekt ligjor, do të mundësojë zgjerimin e spektrit të të dhënave që mblidhen për kandidatët e vetingut, duke mundësuar kështu mbledhjen e të dhënave jo vetëm nga regjistrat publikë por edhe informatave të tjera financiare dhe shëndetësore për kandidatët. Gjithashtu, do të garantojë mbrojtjen ligjore të të dhënave të kandidatëve si dhe mjetet juridike në dispozicion për këtë.

Në aspektin kohor të këtij spektri, do të mundësohet që kontrolli i integritetit apo vetingu të kryhet në baza të rregullta dhe të vazhdueshme. Kështu, secili gjyqtar apo prokuror do të kalojë nëpër veting çdo herë pas disa viteve, dhe çdo herë që një i tillë transferohet apo avancohet në detyrë.

Rrjedhimisht, zbatimi i masave të planifikuara të kësaj objektive specifike do të garantojnë ndërtimin e një sistemi i cili rekruton dhe mbanë gjyqtarë e prokurorë të denjë për të shërbyer në sistemin e drejtësisë dhe për të vendosur për të drejtat e qytetarëve/eve.

4.2. Fuqizimi i sistemit të Drejtësisë Penale

Masat e përzgjedhura në kuadër të objektivës për fuqizimin e sistemit të Drejtësisë Penale kanë për qëllim që të përmirësojnë besueshmërinë e publikut përmes adresimit të katër sfidave kryesore në këtë drejtim: fuqizimi i luftës kundër krimit të organizuar dhe korrupsionit të nivelit të lartë (5.2.1), përmirësimi i profesionalizmit në luftën kundër krimit të organizuar dhe korrupsionit të nivelit të lartë (5.2.2), garantimi i integritetit të Policisë së Kosovës (5.2.3) dhe përmirësimi i ekzekutimit të sanksioneve penale (5.2.4).

	Objektivi strategjik 1	Objektivat specifike	
1	Fuqizimi i sistemit të Drejtësisë Penale	5.2.1	Fuqizimi i luftës kundër krimit të organizuar dhe korrupsionit të nivelit të lartë
		5.2.2	Përmirësimi i profesionalizmit në luftën kundër krimit të organizuar dhe korrupsionit të nivelit të lartë
		5.2.3	Garantimi i integritetit të Policisë së Kosovës
		5.2.4	Përmirësimi i ekzekutimit të sanksioneve penale

Objektivi që ka të bëjë me fuqizimin e luftës kundër krimit të organizuar dhe korrupsionit të nivelit të lartë fokusohet në çështjet që kanë të bëjnë me luftimin e korrupsionit të nivelit të lartë dhe luftimin e krimit të organizuar dhe ndjekjen efikase të këtyre grupeve. Objektiva e veçantë për përmirësimin e profesionalizmit në luftën kundër krimit të organizuar dhe korrupsionit të nivelit të lartë ka për synon që përmes ngritjes profesionale të ketë luftim të korrupsionit të nivelit të lartë, kundër krimit të organizuar dhe po ashtu edhe të luftohet pastrimi i parave. Gjithashtu me këtë objektiv synohet eliminimi i ndërhyrjeve në gjyqësor si dhe forcimi i regjimit të konfiskimit.

Objektivi i veçantë për garantimin e integritetit të Policisë së Kosovës fokusohet në çështjet të cilat kanë të bëjnë me funksionimin e Policisë së Kosovës duke përfshirë mekanizmat e brendshëm të llogaridhënies dhe luftimin e fenomenit të korrupsionit brenda institucionit, pastaj rolit dhe ndërveprimin me IPK-në, bashkëpunimin, dhe ndërveprimin me institucionet tjera ligjzbatuese. Objektiva për përmirësimin e ekzekutimit të sanksioneve penale synon që të bëjë përmirësimin e këtij sektori me rëndësi duke vënë në dukje nevojën e domosdoshme për të aplikuar masa që do të ndikojnë jo vetëm për individët por edhe për shoqërinë.

4.2.1. Fuqizimi i luftës kundër krimit të organizuar dhe korrupsionit të nivelit të lartë

Kjo objektivë specifike fokusohet në çështjet të cilat ndikojnë negativisht në sektorin e sundimit të ligjit, në veçanti lidhur me hetimin dhe ndjekjen efektive të grupeve të organizuara kriminale që veprojnë në dhe rreth Republikës së Kosovës, si dhe në hetimin e korrupsionit të nivelit të lartë. Ndonëse Kodi Penal dhe Kodi i Procedurës Penale ofrojnë një bazë solide për ndjekjen me sukses të këtyre rasteve, përbindja e rasteve të tilla të cilat rezultojnë me aktgjykim dënues është dukshëm më e ultë se mesatarja ndërkombëtare.

Objektivi ka identifikuar tri fusha ku sektori i drejtësisë ka dështuar që në mënyrë konsistente të mbajë përgjegjës ata që abuzojnë me pozitën e tyre publike përmes përfshirjes së tyre në korrupsion të nivelit të lartë, e që rekomandon se duhet të shfrytëzohen më mirë mekanizmat ligjor në adresimin e çështjeve të krimit të organizuar, korrupsionit të nivelit të lartë dhe konvertimit të pasurive të fituara jashtëligjshëm. Aspekti tjetër lidhet me faktin që mbajtja përgjegjës e atyre që janë të përfshirë në afëra korruptive ndihmon në ndërtimin e besimit të qytetarëve/eve sikurse në të atyre që janë të zgjedhur, po ashtu edhe në sektorin e drejtësisë. Po ashtu, aspekti tjetër që paraqet sfidë ka të bëjë me cilësinë e hetimeve që zhvillohen në rastet e korrupsionit të nivelit të lartë dhe krimit të organizuar posaçërisht kur ka të bëjë me hetimin financiar, me çka kërkohet koordinim më i mirë në mënyrë që pasuritë e fituara jashtëligjshëm të konfiskohen. Këtu është e rëndësishme që roli i prokurorëve të forcohet në udhëheqjen e hetimit dhe të ndjeket parimi ‘ndiqni paratë’, i cili është i rëndësishëm së veçantë për hetimin financiar. Ekspertiza financiare gjithashtu synohet të forcohet.

Gjithashtu, synohet ndryshimi i skemës aktuale të konfiskimit të pasurisë, me ç'rast do t'i mundësohet ndarja e përqindjes së caktuar nga të ardhurat që të rrjedhin nga shitja e pasurive të konfiskura për dobi të sektorit të drejtësisë penale.

Për të arritur synimet e parapara me këtë objektivë duhet që të mbështetet zbatimi më i mirë i ligjeve në fuqi, të ketë logaridhënie më të madhe të gjyqtarëve dhe prokurorëve, si dhe të ketë trajnime shitesë për sektorin gjyqësor dhe prokurorial. Sidomos në rastet kur krimi tejkalon kufijtë, bashkëpunimi ndërkombëtar është mëse i nevojshëm dhe duhet tutje të forcohet edhe më shumë për të arritur sukses në hetimet dhe dënimet e këtyre krimeve.

4.2.2. Përmirësimi i profesionalizmit në luftën kundër krimit të organizuar dhe korrupsionit të nivelit të lartë

Objektiva që ka të bëjë me përmirësimin e profesionalizmit dhe ngritjen e kapaciteteve të sektorit të drejtësisë penale ka për qëllim për të mundësuar ndjekje penale të suksesshme të veprave penale të krimit të organizuar, korrupsionit të lartë dhe pastrimit të parave. Përderisa korrupsioni shihet si problemi i dytë më i madh pas papunësisë sipas një ankete të vitit 2018, dhe prokurorët ngritin aktakuza për krim të organizuar dhe korrupsion, ka pak të akuzuar që shpallen fajtorë për këto vepra penale. Palët e përfshira në këtë proces i'a hedhin fajin njëra tjetrës, respektivisht gjykatat dhe prokuroria. Prandaj, me theks të veçantë ky objektiv e ka për synim që ta vështrojë aspektet që lidhen me vlerësimin e performancës dhe vlerësimin të pushtetit të gjyqësorit, trajnimin e

gjyqtarëve dhe prokurorëve dhe gjithashtu edhe me vështrimin në çështjet që kanë të bëjnë me pavarësinë e institucioneve.

Vlerësimi i performancës së prokurorëve dhe gjyqtarëve synohet që të pësojë ndryshime dhe ndër të tjera të ngërthejë specifikisht edhe mentorimin dhe menaxhimin e përgjithshëm, duke përfshirë këtu edhe raportet gjashtë mujore të kontrollit dhe përparimit të kryeprokurorëve rajonalë si dhe kryetarëve të gjykatave, për prokurorët respektivisht gjyqtarët vartës. Një theks i veçantë i jipet edhe shkathhtësisë verbale të prezantimit të prokurorëve në gjykatë dhe ndërveprueshmërinë e tyre me palët tjera dhe rendësisë që kjo të merret parasysh në vlerësimin vjetor të tyre. Gjithashtu, synohet që në vlerësimin e performancës të zë një vend të posaçëm shkrimi dhe arsyetimi ligjor i gjyqtarëve dhe prokurorëve në vendimet, gjegjësisht aktakuzat, e tyre.

Vërehet një domosdoshmëri e theksuar e organizimit të trajnimeve për gjyqtarët dhe prokurorët që trajtojnë krimin e organizaur dhe korrupsionin e nivelit të lartë, kjo për faktin se rritja e profesionalizmit ndikon drejtpërsëdrejti në efikasitetin e tyre për të luftuar me sukses këto fenomene. Për tu ballafaquar sa më me sukses në luftën ndaj korrupsionit të nivelit të lartë dhe krimin të organizuar në këtë objektiv vërehet nevoja e arsimimit të vazhdueshëm ligjor vjetor të detyrueshëm për gjyqtarët dhe prokurorët një ose dy herë në vit, posaçërisht në adresimin e luftës kundër krimin të organizuar dhe korrupsionit. Trajnimi i detyrueshëm duhet të përfshijë gjithashtu etikën ligjore, pastaj të mbulojë sferën e praktikës së gjyqtarëve dhe prokurorëve për ta përmirësuar zhvillimin e karrierës së tyre, si dhe tu krijohet hapësirë për zhvillimin e interesit në fushat e reja. Për qëllim të trajnimeve rekomandohet që AD të zhvillojë programe adekuate për shkrimin ligjor dhe zhvillimin e programeve për menaxhimin progresiv, por që trajnimi përveç gjyqtarëve dhe prokurorëve duhet tu ofrohet edhe anëtarëve të KGJK-së dhe KPK-së me theks të veçantë në administratë dhe çështjet financiare.

4.2.3 Garantimi i integritetit të Policisë së Kosovës

Objektiva që ka të bëjë me garantimin e integritetit të Policisë së Kosovës fokusohet në çështjet që kanë të bëjnë me sfidat me të cilat ballafaqohet e që kanë të bëjnë me korrupsionin policor, integritetin dhe sjelljet tjera kriminale të vërteta e po ashtu edhe të përceptuara. Policia e Kosovës është e pajisur dhe trajnuar mire në aspektin logjistik mirëpo kërkohet që të sfidohet edhe përceptimi për shkeljet e rregullave dhe korrupsionin. Për këtë arsye sjelljet e pahijshme të zyrtarëve policor duhet që të adresohen institucionalisht për të rritur besueshmërinë e publikut dhe inkurajuar edhe më shumë qytetarët, burra dhe gra, të drejtohen për raportim të rasteve, edhe pse Policia e Kosovës në përgjithësi gëzon një reputacion shumë pozitiv në raport me institucionet tjera të zbatimit të ligjit.

Policia e Kosovës dhe IPK kanë shfaqur gatishmëri për të bashkëpunuar për të luftuar korrupsionin dhe shkeljet, si dhe sjelljet tjera të pahijshme të zyrtarëve policor. Luftimi i korrupsionit dhe krimin të organizuar kërkon edhe vullnet politik dhe kërkon bashkërendim dhe bashkëpunim më efikas të agjensive që merren me zbatimin e ligjit. Bashkëpunimi i Policisë së Kosovës dhe IPK-së me

prokurorinë është tejet i rëndësishëm sepse do t'i krijonte parakushtet që të zbatohen hetime adekuate që përkthehet pastaj në rezultate pozitive.

Rekomandohet po ashtu që Policia e Kosovës të krijojë kulturë etike që nënkupton se punonjësit e saj duhet të jenë në gjendje të ballafaqohen dhe të dijnë si ta zbatojnë kodin etik në praktikë. Për këtë shkak nevojitet trajnim që nga rekrutimi për të vazhduar pastaj me programin e trajnimit në terren. Edhe tek deklarimi i pasurisë synohet që përveç obligimit që kanë zyrtarët e lartë për ta bërë një gjë të tillë, që të gjithë hetuesit të cilët janë të ngarkuar me hetime penale të nivelit të lartë ta bëjnë një gjë të tillë.

Po ashtu, duhet të mbështeten trajnime të përbashkëta me zyrtarët e zbatimit të ligjit, prokurorët dhe gjyqtarët në mënyrë që të krijohet një sinergji, plotësim, bashkërendim dhe më tepër bashkëpunim qoftë në të kuptuarit e ligjeve që mbulojnë këtë fushë specifike por edhe për të parë mundësinë e unfikimit kompjuterik ndërinstytucional për të menaxhuar lëndët për policinë, prokurorinë dhe gjykatën, duke mbajtur dhe raportuar të dhëna të ndara, përfshirë edhe në baza gjinore.

Gjykatat rekomandohet që të mbështesin përpjekjet e Policisë së Kosovës për ruajtjen e integritetit institucional duke ndjekur në mënyrë të duhur të gjitha rastet e sjelljeve kriminale të pretenduara kundër personelit policor, kur ka dyshim të bazuar dhe prova të mjaftueshme për të mbështetur gjetjen e fajësisë. Po ashtu, Policia e Kosovës në bashkëpunim me IPK-në duhet të zbatojnë inspektive të rregullta dhe auditime të brendshme për të rritur konotrollin dhe llogaridhënien në të gjitha nivelet brenda vet institucionit.

4.2.4. Përmirësimi i ekzekutimit të sanksioneve penale

Objektiva e katërt që ndërlidhet me ekzekutimin e sanksioneve penale ka të bëjë me investimet e vazhdueshme për të zhvilluar dhe fuqizuar këtë sektor të rëndësishëm për t'iu përshtatur standardeve dhe ndryshime globale. Për të pasur sukses në fuqizimin e sistemit për ekzekutimin e sanksioneve penale duhet që të rritet bashkëpunimi i SHKK-së dhe SHSK-së, që përveç fokusimit që kanë në rehabilitimin e shkelësve të ligjit, të krijojnë edhe mekanizma për të shfrytëzuar burimet e përbashkëta për të arritur synimet e kërkuara.

Ky bashkëpunim duhet të synojë arritjen e objektivave që shpiejnë në korrigjimin dhe përmirësimin e problemeve të identifikuara, e që kanë të bëjnë me: fuqizimin e aftësive të planifikimit strategjik të këtyre institucioneve; riorganizimin e infrastrukturës së SHKK; zhvillimin e politikës së burimeve njerëzore të SHKK dhe SHSK; krijimin dhe zhvillimin e një vlerësimi të qëndrueshëm të rreziqeve dhe nevojave dhe sistemi individual për planifikimin e burgimit për të burgosurit dhe klientët provues; fokusimin në rehabilitimin dhe risocializimin e të burgosurve; zhvillimin e legjislacionit; zhvillimin tutje të Shërbimit Sprovues të Kosovës dhe mbështetjen e përdorimit të sanksioneve dhe masave alternative; si dhe zhvillimin e legjislacionit për sanksionet dhe masat e komunitetit.

Ligji për ekzekutimin e sanksioneve penale është zhvilluar dhe ka pësuar ndryshime të shpeshta viteve të fundit, mirëpo nuk e ka përcaktuar strukturën dhe funksionimin e SHKK-së dhe SHSK-së qartë, për shkak se është një kombinim i ligjeve që përcaktojnë ekzekutimin e sanksioneve penale dhe për këtë shkak nevojitet nxjerrja e ligjeve të veçanta që e rregullojnë strukturën organizative të SHKK-së dhe SHSK-së.

Përdorimi i sanksioneve penale dhe masave alternative duhet të promovohet më tepër në Kosovë. Tek të miturit shqiptohen më tepër masat alternative, mirëpo tek të rriturit ende ekziston një numër i vogël. Për këtë arsye një zbatim më i madh i këtyre masave do të ndikonte në uljen e shpenzimeve të shtetit sepse bëhet shmangia e dënimit me burg. Po ashtu, shqiptimi i këtyre masave dhe shmangia e dënimit me burg do të kishte ndikim edhe në aspektin social dhe familjar sepse kryeresit do të mbeteshin në shoqëri dhe pasojat sociale do të ishin më të vogla.

Synohet po ashtu, që për të arritur një nivel të kënaqshëm të zbatimit më të madh të masave alternative, duhet domosdoshmërisht që rritet vetëdijësimi i prokurorëve dhe gjyqtarëve për t'i promovuar këto masa. Për të arritur këtë synim nevojitet bashkëpunim më i mirë i të gjithë akterëve të përfshirë që të arrihet sukses në zbatim. Këtë rol do ta luante SHSK duke hartuar raportin para dënimit, në të cilin raport SHSK do ta vlerësojë sa është relevante një sanksion alternativ për individin dhe në këtë formë do të rritet besueshmëria e sanksioneve alternative tek prokurorët dhe gjyqtarët.

4.3. Fuqizimi i Qasjes në Drejtësi

Masat e përzgjedhura në kuadër të objektivës strategjike për fuqizimin e qasjes në drejtësi synojnë që të shënjestrojnë ndërtimin e besimit të qytetarëve në drejtësi dhe realizimin e të drejtave të tyre në praktikë duke intervenuar në adresimin e pesë sfidave kryesore në këtë drejtim: përmirësimin e qasjes në gjykata dhe prokurori (5.3.1), ngritjen e efikasitetit dhe efektivitetit të mjeteve juridike (5.3.2), përmirësimin e ofrimit të shërbimeve nga profesionet e lira (5.3.3) rritjen e bashkëpunimit dhe koordinimit me shoqërinë civile dhe (5.3.4), fuqizimin e rolit të Ministrisë së Drejtësisë (5.3.5).

	Objektivi strategjik 3	Objektivat specifike	
1	Fuqizimi i qasjes në Drejtësi	5.3.1	Përmirësimi i qasjes në gjykata dhe prokurori
		5.3.2	Ngritja e efikasitetit dhe efektivitetit të mjeteve juridike
		5.3.3	Përmirësimi i ofrimit të shërbimeve nga profesionet e lira
		5.3.4	Rritja e bashkëpunimit dhe koordinimit me shoqërinë civile

		5.3.5	Fuqizimi i rolit të Ministrisë së Drejtësisë
--	--	-------	--

Intervenimet e parapara në kuadër të objektivës specifike për fuqizimin e qasjes në drejtësi për qytetarë/e, synojnë të bëhen në lehtësimin e qasjes së qytetarëve/eve në gjykata dhe prokurori, përmes përmirësimit të garancive juridike, zvogëlimit të numrit të lëndëve të vjetra, ngritjes së kompetencave dhe rolit të Institucionit të Avokatit të Popullit dhe përmirësimit të bashkëpunimit në mes të organeve gjyqësore dhe atyre jo-gjyqësore. Përmes ngritjes së efektivitetit dhe efikasitetit të mjeteve juridike për qytetarë/e dhe zbatimit të tyre në praktikë, institucionet e drejtësisë dhe ato të zbatimit të ligjit do të jenë më afër dhe në shërbim të qytetarit/es. E drejta për gjykim brenda një afati të arsyeshëm kohor, e drejta për avokat mbrojtës, realizimi i drejtave dhe lirive të garantuara me Kushtetutë dhe ligj si në aspektin material ashtu edhe atë procedural janë orientimet thelbësore të kësaj objektivë specifike.

Objektiva mbi përmirësimin e ofrimit të shërbimeve nga profesionet e lira ligjore (PLL), do të fuqizojë rolin e tyre në njërën anë, dhe njëkohësisht garantojë ofrimin e shërbimeve cilësore dhe efikase për qytetarët/et. Përderisa, objektiva e katërt përmes bashkëpunimit dhe bashkëveprimit me shoqërinë civile do të ndikoj në rritjen e jashtme të transparencës dhe llogaridhënies së institucioneve të drejtësisë dhe sigurisë, kthimin e besimit të qytetarëve/eve në institucione dhe lehtësimin e qasjes në informata për shoqërinë civile dhe avokimin për të përmirësuar integritetin, imazhin dhe besueshmërinë e institucioneve.

4.3.1. Përmirësimi i qasjes në gjykata dhe prokurori

Kjo objektivë specifike e vendos qytetarin/en në qendër. Qasja në drejtësi si komponentë kyçe e sundimit të ligjit, zhvillimit dhe rritjes gjithëpërfshirëse, dhe e qeverisjes së mirë siguron barazi në shoqëri, zvogëlon dhunën dhe diskriminimin, sidomos ndaj grupeve të cënueshme, dhe zvogëlon koston dhe kohën e realizimit të të drejtave të individëve.

Si masë e parë e kësaj objektivë parashihet përmirësimi i garancive juridike zyrtare për gjykim të drejtë, përfshirë ndihmën juridike falas. Në këtë drejtim parashihet miratimi i një ligji të vetëm për ndihmë juridike falas me qëllim të krijimit të një sistemi unik, transparent dhe llogaridhënës, dhe njëkohësisht të aftë për të ofruar shërbime në të gjitha fushat, për të gjithë në nevojë. Këtu do të parashihen edhe kritere më të qarta për emërimin e avokatëve për ndihmë juridike.

Tutje, masat për avancimin e qasjes në shërbimet e gjykatave dhe prokurorive do ta rrisin përdorimin e mekanizmave të zgjidhjes alternative të kontesteve (ZAK), do të sigurojnë shërbime më të lira dhe më të parashikueshme, dhe informacione publike më lehtë të qasshme për qytetarët. Në kuadër të kësaj mase, mes tjerash, do të bëhet edhe ri-vlerësimi i kompetencës së vetme territoriale të Departamentit Administrativ të Gjykatës Themelore në Prishtinë bazuar në praktikat e CEPEJ. Si pjesë e kësaj mase është paraparë edhe përcaktimi i shpenzimeve dhe tarifave gjyqësore përmes miratimit të ligjit primar nga Kuvendi i Kosovës.

Një sërë veprimesh konkrete janë paraparë në kuadër të masës së tretë të kësaj objektive e që kanë për synim përmirësimin e qasjes në drejtësi për personat dhe grupet e cenuara, në përputhje edhe me Konventën e KiE për parandalimin dhe luftimin e dhunës ndaj grave dhe dhunës në familje, e cila është tanimë pjesë e Kushtetutës së Kosovës. Aktivitetet e propozuara në kuadër të kësaj mase synojnë avancimin e kapaciteteve të institucioneve relevante për luftimin e dhunës në baza gjinore, thellimin e bashkëpunimit dhe koordinimit në mes të institucioneve gjyqësore dhe jo gjyqësore për luftimin e dhunës në baza gjinore dhe mbështetje më të madhe financiare për strehimoret e viktimave të dhunës në baza gjinore.

Masa e katërt e paraparë në kuadër të kësaj objektive propozon aktivitete drejt krijimit të një bashkëpunimi efektiv në mes të organeve jo gjyqësore dhe gjykatave dhe prokurorive. Theks i veçantë në kuadër të kësaj mase i është kushtuar fuqizimit të rolit të Institucionit të Avokatit të Popullit (IAP). Kjo do të ndikonte dukshëm në përmirësimin e të drejtave të njeriut në Kosovë dhe po ashtu do ta rriste përgjegjësinë e autoriteteve publike karshi pretendimeve të ngritura të qytetarëve/eve për shkelje të të drejtave të njeriut.

4.3.2. Ngritja e efikasitetit dhe efektivitetit të mjeteve juridike

Objektiva specifike për ngritjen e efikasitetit dhe efektivitetit të mjeteve juridike, synon që të promovojë përmirësimin e garancive ligjore për mbrojtjen gjyqësore lidhur me realizimin e të drejtave themelore në çështjet penale, civile dhe administrative. Rritja e numrit të mjeteve juridike të disponueshme për mosfunksionimet e sistemit të drejtësisë dhe për të rritur efektivitetin e tyre si dhe ofrimi i shërbimeve ligjore që janë me kohë, efektive dhe efikase për të gjithë qytetarët e Kosovës do të rris besimin e qytetarëve në sistemin e drejtësisë dhe do të ndikoj që të drejtat e tyre të zbatohen në praktikë.

Kjo objektivë strategjike do të përmirësojë qasjen në shërbimet e ndihmës juridike për qytetarët me të ardhura të ulëta, përfshirë përmirësimin dhe mbrojtjen adekuate të të drejtave të personave të privuar nga liria. Ajo gjithashtu synon, siç u cek më lartë, fuqizimin e rolit të Avokatit të Popullit për të adresuar shkeljet e të drejtave të njeriut.

Kjo objektivë strategjike synon që qytetarët e Kosovës të përfitojnë nga e drejta kushtetuese për gjykim të drejtë brenda një kohe të arsyeshme dhe mjetet juridike të jenë të disponueshme dhe efektive edhe në praktikë. Kjo do të realizohet përmes ndryshimeve të mundshme ligjore për mbrojtjen e së drejtës për gjykim brenda një kohe të arsyeshme për të përcaktuar mjetet juridike efektive për çështjet që përfshijnë vonesa në procedimet gjyqësore. Një ligj i tillë do të mund të paraqiste, ndër të tjera, të drejtën e ankesës përpara Gjykatës Kushtetuese; të drejtën e ankesës në një gjykatë të shkallës më të lartë; futjen e mjeteve juridike përshpejtuese dhe kompensuese e mjeteve juridike specifike për drejtësinë penale. Kështu, mjete juridike shtesë do të ishin në dispozicion, të cilat do të shtonin efektivitetin e mbrojtjes së të drejtave themelore dhe procedurale të qytetarëve/eve.

Përmes vlerësimit gjithëpërfshirës dhe analitik të afateve procedurale në fuqi të përcaktuara në fushat penale, civile dhe administrative, do të përcakton nevojën që legjislacioni përkatës të ndryshohet në mënyrë thelbësore duke vendosur afate të reja procedurale që janë reale dhe praktike, duke e marrë parasysh gjendjen ekzistuese në gjykatat dhe prokuroritë e Kosovës, si dhe standardet profesionale të synuara.

Më tutje, ky objektiv strategjik synon të promovojë të drejtat dhe liritë e njeriut, përmes shtimit të masave mbrojtëse ligjore të personave që janë subjekt i procedurave penale (mbrojtja ndaj keqtrajtimit, të drejtën e qasjes në avokat mbrojtës, të drejtën e interpretimit dhe përkthimit), në përputhje me standardet evropiane, si dhe masave tjera në procedurën civile edhe atë të kontesteve administrative..

Përmes përmbushjes së këtyre objektivave strategjike, institucionet publike në Kosovë do të marrin masat e nevojshme për të rritur bashkëpunimin e tyre institucional në zhvillimin e njohurive dhe aftësive të personelit në lidhje me kuptimin dhe familjarizimin e parimeve themelore dhe standardeve të mishëruara në KEDNJ-në dhe praktikën gjyqësore të GJEDNJ-së. Institucionet e drejtësisë dhe agjencitë e zbatimit të ligjit do të organizojnë aftësime të rregullta të ofruara për profesionistët e tyre për praktikën gjyqësore të GJEDNJ-së.

4.3.3. Përmirësimi i ofrimit të shërbimeve nga profesionet e lira

Objektiva mbi përmirësimin e ofrimit të shërbimeve nga profesionet e lira ligjore (PLL), synon fuqizimin e mëtutjeshëm të roleve dhe kompetencave përkatëse të PLL-ve me qëllim të ngritjes së cilësisë së shërbimeve të ofruara nga PLL-të, duke pasur parasysh karakteristikat e tyre të veçanta.

Si masë e parë në kuadër të kësaj objektive parashihet zhvillimi dhe konsolidimi i mëtejme i ndërmjetësimit dhe procedurave të falimentimit. Në kuadër të kësaj mase, është paraparë ndryshimi i ligjit për falimentimin dhe harmonizimi i tij me ligjet tjera relevante me qëllim të heqjes së pengesave aktuale për zbatimin e procedurave të falimentimit. Është paraparë po ashtu edhe themelimi i Odës së Administratorëve të Falimentimit dhe ofrimi i mbështetjes së nevojshme financiare dhe infrastrukturore për funksionalizimin e saj dhe të Odës së Ndërmjetësuesve. Kjo masë po ashtu parasheh edhe krijimin e një mekanizmi koordinues efektiv dhe fleksibil në mes të autoriteteve përkatëse shtetërore me qëllim të funksionalizimit të zyrave të ndërmjetësimit në gjykata dhe prokurori. Si aktivitet tjetër, është paraparë edhe ngritja e vetëdijes në mesin e qytetarëve dhe bizneseve, por edhe përbrenda sistemit të drejtësisë, për rolin dhe dobitë e mekanizmave të ndërmjetësimit dhe falimentimit, dhe rritjes së përdorimit të këtyre mekanizmave. Në kuadër të kësaj mase, parashihet po ashtu edhe shtimi i numrit të përmblyesve privat për një shpërndarje më të mirë gjeografike, dhe krijimi i një sistemi uniform për mbledhjen e të dhënave, për të pasur një pasqyrë më të mirë të performancës së sistemit.

Në kuadër të masës së dytë, janë paraparë një vargë aktivitetesh që kanë për qëllim ngritjen e cilësisë së shërbimeve të të gjitha PLL-ve. Kjo do të arrihet përmes hartimit/përmirësimit të kurrikulave trajnuese fillestare, të vazhdueshme dhe të specializuara për të gjitha PLL-të mbi bazën

e analizave gjithëpërfshirëse të nevojave përkatëse të trajnimit. Këto trajnime do të jenë të obligueshme për PLL-të, me qëllim të rritjes së njohurive dhe shkathtësive të PLL-ve dhe shtimit të besimit të publikut në shërbimet e ofruara nga ta. Kjo do të kërkojë një bashkërendim dhe bashkëpunim efektiv ndër-institucional, ku rol kyç do të luaj edhe Akademia e Drejtësisë. Përveç trajnimeve, kjo masë parasheh edhe përmirësimin e monitorimit ndaj PLL-ve, përmes hartimit/ndryshimit të Kodeve të Sjelljes, krijimit të standardeve profesionale dhe qartësimit si dhe fuqizimit të kompetencave dhe kapaciteteve dhe bashkërendimit të aktiviteteve përbrenda strukturave të MD-së. Si masë tjetër përmes së cilës do të arrihet kjo objektivë është edhe përmirësimi i bashkëpunimit ndër-institucional (PLL-ve, sistemit gjyqësor dhe prokurorial dhe akterëve të tjerë), përmes krijimit të mekanizmave dhe kanaleve efektive të komunikimit dhe bashkëpunimit.

Përmes kësaj objektive do të arrihet edhe lehtësimi i ngarkesës së punës në gjykata dhe prokurori, si dhe garantimi i ekzistimit të sundimit të ligjit që siguron të drejtën për gjykim dhe shqyrtim të drejtë në një afat të arsyeshëm kohor për qytetarët/et.

4.3.4. Rritja e bashkëpunimit dhe koordinimit me shoqërinë civile

Objektiva e katërt specifike synon ngritjen e bashkëpunimit dhe bashkëveprimit në mes të institucioneve të drejtësisë dhe sigurisë me sektorin e shoqërisë civile në Kosovë, përmes ngritjes së transparencës së këtyre institucioneve. Kjo do të realizohet përmes lehtësimit të qasjes së monitorimit efektiv të punës dhe performancës së sistemeve të drejtësisë dhe institucioneve të sigurisë nga organizatat e shoqërisë civile, mediat dhe publiku, me qëllim të rritjes së mëtutjeshme të llogaridhënies dhe transparencës së funksionimit të tyre, duke përfshirë qasshmërinë e informacioneve në sistemin gjyqësor dhe prokurorial, Ministrinë e Drejtësisë, Ministrinë e Punëve të Brendshme dhe në Policinë e Kosovës.

Masa e parë në kuadër të kësaj objektive fokusohet në ofrimin e mundësive dhe ofrimit të qasjes konstruktive për shoqërinë civile për pjesëmarrje efektive të shoqërisë civile në monitorimin e institucioneve publike, duke shfrytëzuar rolin e saj në funksionet e avokimit dhe ndërgjegjësimit të publikut lidhur me funksionimin dhe operimin e këtyre institucioneve.

Përmes kësaj objektive synohet që përvoja dhe ekspertiza e organizatave joqeveritare të ndahet me gjyqtarët dhe prokurorët, në bashkëpunim me Akademinë e Drejtësisë dhe këshillat. Këtu synohet ndërtimi i praktikës që KGJK-ja, KPK-ja, gjykatat dhe prokuroritë, në përputhje me Ligjin për Qasje në Dokumente Publike dhe Ligjin për Mbrojtjen e të Dhënave, t'u përgjigjen kërkesave për qasje në informata dhe dokumente publike, duke përfshirë në mënyrë të rregullt, shpalosjen e të dhënave të tilla për të gjitha palët e interesuara.

Propozimi tjetër fokusohet në ndërtimin e urave të bashkëpunimit në mes të KGJK-së, KPK-së, kryetarëve të gjykatave dhe kryeprokurorëve me OJQ-të e interesuara në formë të takimeve të rregullta ndërmjet tyre, duke lejuar shkëmbimin e përvojave dhe dhënien me kohë të informatave kthyesë, garancia se të gjitha gjykatat ofrojnë kushte që lejojnë monitorimin e gjykimeve dhe

qasjen për publikun në seanca gjyqësore. Synohet gjithashtu që KGJK-ja dhe KPK-ja të sigurojnë që OJQ-të e interesuara mund të japin mendime në debatin publik për funksionimin e gjyqësorit dhe një debat i tillë publik të jetë përmbajtësor dhe të synojë zgjidhjen e problemeve dhe rritjen e njohurive dhe besimit ndërmjet sistemit gjyqësor dhe prokurorial, në njëërën anë, dhe OSHC-ve në anën tjetër.

Masë tjetër e këtij objektivi strategjik është që MD-ja, MPB-ja dhe Policia e Kosovës të rrisin më tej aftësitë dhe mundësitë e tyre të brendshme dhe burimet njerëzore për komunikim me publikun dhe mediat, dhe OSHC-të, përfshirë kërkesën që këto institucione të zhvillojnë dhe të mirëmbajnë më tej kanalet e qasshme të komunikimit, faqet e internetit, si dhe të vënë në dispozicion të publikut informata, të dhëna dhe statistika në lidhje me funksionimin dhe operimin e tyre institucional.

4.3.5 Fuqizimi i rolit të Ministrisë së Drejtësisë

Objektiva e pestë strategjike ka për qëllim ngritjen e rolit të Ministrisë së Drejtësisë, në monitorimin dhe mbikëqyrjen e zbatimit të reformës së drejtësisë. Me theks të veçantë, Ministria e Drejtësisë përmes zbatimit të kësaj objektive do të ketë rol kyç në bashkëpunim të plotë me KGJK-në, KPK-në dhe organet tjera në sistemin e drejtësisë, në identifikimin e dobësive në funksionimin e sistemit të drejtësisë dhe adresimin e tyre përmes planifikimit adekuat dhe hartimit të masave të nevojshme të politikave dhe legjislative për të përmirësuar problemet e paraqitura, drejt ngritjes së pavarësisë, paanësisë, llogaridhënies, profesionalizmit dhe efikasitetit të sistemit të drejtësisë në Kosovë.

Synim tjetër i kësaj objektive strategjike, është edhe rishqyrtimi organizativ i Ministrisë së Drejtësisë dhe forcimi i departamenteve ekzistuese. Përmes zbatimit të masave të përcaktuara në këtë objektive, synohet të krijohet njësi për politikën e gjyqësorit. Ministria e Drejtësisë synon gjithashtu që të rris profesionalizmin dhe specializimin e Departamentit Ligjor në fusha specifike si penale, civile, administrative, tregtare.

Me shumë rëndësi, propozohet krijimi i një njësie të Analitikës dhe Monitorimit statistikor, që pritet të pajisë Ministrinë me të dhëna empirike, të nxjerra me metoda të mirëfillta shkencore, të cilat do t'i ndihmojnë asaj në politikbërje më të mirë si për gjyqësorin ashtu edhe për të gjithë sistemin e drejtësisë. Në fund, propozohen edhe një sërë investimesh drejt fuqizimit të Divizionit të TI-së që të aftësohet për të bashkërenduar sistemet informatve dhe kompjuterike me ato të gjyqësorit, si dhe forcimi i mëtutjeshëm i Departamentit për Integrim Evropian dhe Koordinim të Politikave.

4.4. Fuqizimi i luftës anti-korrupsion

Masat e parapara në kuadër të objektivës për fuqizimin e luftës anti-korrupsion mëtojnë: Përmirësimin e kornizës institucionale kundër korrupsionit (5.4.1) dhe përmirësimin e sistemit të deklarimit të pasurisë dhe rregullativës për pranimin e dhuratave (5.4.2).

	Objektivi strategjik	Objektivat specifike	
5.4	Fuqizimi i luftës anti-korrupsion	5.4.1	Përmirësimi i kornizës institucionale kundër korrupsionit
		5.4.2	Përmirësimi i sistemit të deklarimit të pasurisë dhe rregullativës për pranimin e dhuratave

Objektiva specifike për përmirësimin e kornizës institucionale kundër korrupsionit shpalojë intervenimet strategjike të cilat kanë për qëllim avancimin e luftës kundër korrupsionit përmes koordinimit dhe strukturimit sa më efikas të të gjithë akterëve të përfshirë. Intervenimet e parapara në kuadër të objektivës për përmirësimin e sistemit të deklarimit të pasurisë dhe rregullativës për pranimin e dhuratave, në anën tjetër, synojnë të arrijnë një sistem llogaridhënës, të qëndrueshëm dhe transparent të deklarimit të pasurisë dhe pranimin të dhuratave.

4.4.1 Përmirësimi i kornizës institucionale kundër korrupsionit

Përmirësimi i kornizës institucionale kundër korrupsionit, si objektivë specifike, fokusohet në ndërtimin e një kornize të qëndrueshme institucionale dhe legjislative e cila është e pajisur me të gjitha mjetet e nevojshme për parandalimin dhe luftimin e suksesshëm të korrupsionit.

Duke qenë se skema aktuale institucionale kundër korrupsionit është tejet e ndërlikuar, me mbi 20 institucione të përfshira direkt apo tërthorazi në të, qartësimi i rolit dhe përgjegjësi të secilit organ kompetent për luftimin e korrupsionit, është njëra prej masave kryesore që ofron kjo objektivë. Krahas kësaj, Strategjia parasheh transformimin e Agjencisë kundër Korrupsionit në Agjencinë për Parandalimin e Korrupsionit. Zgjerimi i mandatit të Agjencisë në parandalimin e korrupsionit, pritet të ofrojë rezultate më afatgjate në krahasim me kufizimin e saj vetëm në luftimin e korrupsionit. Përmirësimi i punës së strukturave kyçe në luftën kundër korrupsionit në kuadër të Policisë, Inspektoratit Policor, dhe Prokurorisë Speciale të Kosovës janë masa tjera të parapara në kuadër të kësaj objektivë. Këto masa kanë të bëjnë kryesisht me ngritje e kapaciteteve në kuadër të strukturave përkatëse, fuqizimi i bazës ligjore dhe operative për funksionimin e tyre dhe përmirësimi i standardeve të integritetit dhe llogaridhënies. Së fundi, me qëllim të luftimit sa më të suksesshëm të korrupsionit dhe optimizimit të krijimit të rezultateve, parashihet edhe bashkëpunimi me akterët jo shtetëror të përfshirë në luftimin e korrupsionit, por edhe fuqizimi i sistemit të sinjalizimit.

Zbatimi i këtyre masave pritet të rritë besimin ndaj angazhimit politik në luftimin e korrupsionit të nivelit të lartë, të parandalojë humbjet e mëdha ekonomike si pasojë e veprave korruptive dhe, përfundimisht, të sjellë fryte afatgjate në luftën kundër korrupsionit.

4.4.2 Përmirësimi i sistemit të deklarimit të pasurisë dhe rregullativës për pranimin e dhuratave në Kosovë

Objektiva specifike për përmirësimin e sistemit të deklarimit të pasurisë dhe rregullativës për pranimin e dhuratave, synon krijimin e një sistemi i cili promovon kulturë të integritetit dhe llogaridhënies, inkurajon sjellje etike dhe avancojnë besimin e qytetarëve në sektorin publik. Një sistem efikas dhe i qëndrueshëm i deklarimit të pasurisë dhe pranimin të dhuratave, do të shërbente njëkohësisht edhe si burim i sigurtë i informacionit për hetimin e pasurimit të paligjshëm dhe luftimin e korrupsionit në përgjithësi.

Instalimi i ndryshimeve në kornizën ligjore, trajnimi dhe ngritja e kapaciteteve në strukturat relevante dhe avancimi i bashkëpunimit ndërkombëtar, janë tre masat konkrete përmes të cilave parashihet realizimi i kësaj objektive.

Ndryshimet e propozuara me masën e parë, do të qartësonin dhe harmonizonin konceptet përkufizuese të subjekteve të cilët i nënshtrohen obligimit për deklarim të pasurisë, do të zgjeronin përmbajtjen e asaj çfarë duhet deklaruar, do të prezantonin rregulla të detajuara lidhur me deklarimin e dhuratave, dhe do të përcaktonin kriteret për shpalosjen publike të këtyre deklarimeve. Përmes kësaj mase, garantohet edhe verifikimi dhe monitorimi i deklarimeve me qëllim të vërtetimit të saktësisë së tyre. Gjithashtu, propozohet rikualifikimi i mos raportimit të pasurisë si shkelje administrative dhe/ose disiplinore, ndërsa cilësimi fillestar i mos raportimit si vepër penale sugjerohet të ruhet vetëm në rastet e mos raportimeve të përsëritura.

Trajnimi dhe ngritja e kapaciteteve, si masë e dytë, fokusohet në zhvillimin e një programi trajnues për zyrtarët publik të angazhuar në administrimin dhe hetimin e deklarimeve të pasurisë dhe zhvillimin e një kurrikule trajnimit për gjyqtarë dhe prokurorë e cila do të inkurajonte interpretim uniform dhe zbatim të njëjtë të dispozitave ligjore lidhur me mos raportimin apo raportimin e rremë të pasurisë, dhuratave apo dobive të tjera materiale.

Avancimi i bashkëpunimit ndërkombëtar, si masë e fundit, targeton forcimin e pjesëmarrjes së Kosovës në negociatat për miratimin e traktateve ndërkombëtare të kësaj fushe dhe lidhjen e marrëveshjeve bilaterale dhe memorandumeve të mirëkuptimit me agjenci të huaja e vendore përgjegjëse për monitorimin e deklarimit të pasurisë.

Implementimi i këtyre masave avancojnë luftimin e korrupsionit përmes krijimit të një sistemi llogaridhënës, transparent dhe të qëndrueshëm të deklarimit të pasurisë dhe një rregullative solide për pranimin e dhuratave.

5.0. ARANZHIMET E ZBATIMIT, MONITORIMIT DHE RAPORTIMIT

Monitorimi i zbatimit të Strategjisë së Sundimit të Ligjit, si strategji sektoriale është i rregulluar sipas manualit për planifikimin, hartimin dhe monitorimin e dokumenteve strategjike dhe planeve

të tyre të veprimit, i cili buron nga UA Nr. 07/2018 mbi planifikimin dhe hartimin e dokumenteve strategjike dhe planeve të veprimit.

Institucioni udhëheqës për monitorimin e vazhdueshëm dhe koordinimin e zbatimit të strategjisë është **Ministria e Drejtësisë (MD)**. Disa prej institucioneve mbështetëse më kryesore në procesin e monitorimit dhe zbatimit të strategjisë sektoriale për sektorin e sundimit të ligjit janë, në veçanti: Këshilli Gjyqësor i Kosovës, Këshilli Prokurorial i Kosovës, Gjykata Supreme, Gjykata e Apelit, Shërbimi Korrektues i Kosovës, Shërbimi Sprovues i Kosovës, Policia e Kosovës, Akademia e Drejtësisë, Agjencia Kundër Korrupsionit, Oda e Avokatëve të Kosovës, Prokuroria Speciale e Kosovës, Prokuroria e Shtetit, Prokuroria e Apelit, ATK, Dogana e Kosovës, Oda e Noterëve, Oda e Përmbauesve Privatë, Asociacioni i Ndërmjetësuesve, Agjencia për Ndihmë Juridike Falas, Institucioni i Avokatit të Popullit, Komisioni Rregullativ i Prokurimit Publik, Zyra e Kryeministrit, Zyra për Planifikim Strategjik, Ministria e Financave, Ministria e Punëve të Brendshme, Ministria e Administratës Publike, si dhe Ministria e Tregtisë dhe Industrisë.

Pjesë përbërëse e strategjisë është plani i veprimit për periudhën 2021-2023, i cili elaboron në hollësi objektivat strategjike dhe specifike, veprimet, institucionet përgjegjëse, koston financiare për zbatim si dhe treguesit (vlera bazë, synimi afatmesëm dhe përfundimtar). Vlen të theksohet se ky plan i veprimit merr parasysh aspektin gjinor si dhe të dhënat nga zbatimi i tij do të ndahen sipas gjinisë, aty ku është e mundshme.

Ministria e Drejtësisë do të përcaktojë procedura më të detajuara të zbatimit, monitorimit dhe raportimit për institucionet pjesëmarrëse në baza periodike, duke ndjekur parimet kryesore të mëposhtme:

- Në nivelin teknik, Ministria e Drejtësisë do të krijojë dhe koordinojë **organin koordinues ndër-institucional** për të siguruar monitorimin e rregullt të zbatimit të strategjisë dhe planit të veprimit, kryerjen e rishikimeve të përkohshme dhe vlerësimin përfundimtar të dokumentit strategjik. Organi koordinues ndër-institucional i strategjisë do të takohet të paktën dy herë në vit për të diskutuar mbi progresin dhe raportet periodike.
- Përfaqësuesit kryesor në organin koordinues ndër-institucional do të jenë:
 - (1) Ministria e Drejtësisë (Sekretari i Përgjithshëm – bashkëkryesues)
 - (2) Zyra për Planifikim Strategjik (Drejtori i ZPS - bashkëkryesues)
 - (3) Këshilli Gjyqësor i Kosovës (Drejtori i Përgjithshëm i Sekretariatit të KGJK)
 - (4) Këshilli Prokurorial i Kosovës (Drejtori i Përgjithshëm i Sekretariatit të KPK)
 - (5) Ministria e Punëve të Brendshme (Sekretari i Përgjithshëm)
 - (6) Ministria e Financave (Sekretari i Përgjithshëm)
 - (7) Përfaqësues nga Policia e Kosovës
 - (8) Përfaqësues nga Akademia e Drejtësisë
 - (9) Përfaqësues nga Agjencia Kundër Korrupsionit
 - (10) Përfaqësues nga OJQ-të
 - (11) Përfaqësues nga institucione tjera përgjegjëse në zbatimin e strategjisë
- Sekretariati i organit koordinues ndër-institucional në MD (DIEKP) është mekanizmi kryesor që siguron zbatimin, monitorimin dhe raportimin cilësor dhe me kohë duke mbledhur të dhëna dhe informacione nga institucionet udhëheqëse dhe mbështetëse për zbatimin e strategjisë dhe planit të veprimit, të cekura më lartë. Në këtë drejtim do të

përdoren praktika të zakonshme për mbledhjen e të dhënave lidhur me zbatimin e dokumenteve strategjike siç janë ERA, PKZMSA ose strategjitë tjera sektoriale.

- Përgatitja e raporteve të rregullta vjetore mbi zbatimin e strategjisë dhe atyre gjashtëmujore për zbatimin e planit të veprimit do të bëhen nga Sekretariati i organit koordinues ndërinstitucional. Këto raporte do t'i paraqiten pastaj organit koordinues ndërinstitucional të strategjisë për diskutim (shih më poshtë *Fig. 2: Shpeshësia e raporteve të monitorimit të strategjisë*);
- Raportet e lartpërmendura pastaj shqyrtohen dhe miratohen nga **Komiteti Drejtues i Strategjisë**, që është trupa kryesore drejtuese e strategjisë dhe planit të veprimit. Ky Komitet përbëhet nga përfaqësues të nivelit të lartë dhe përbërja e tij specifike është e përcaktuar në figurën e mëposhtme.




Figura 1: Piramida e strukturave institucionale lidhur me arazhimet e zbatimit të strategjisë




Figura 2: Përbërja e Komitetit Drejtues të Strategjisë

Në anën tjetër, Roli i Komisionit për Planifikim Strategjik dhe i Qeverisë së Kosovës në raport me këtë Strategji është i përcaktuar me Vendimin e Qeverisë nr. 04/12.²⁶

²⁶ Vendimi i Qeverisë Nr. 04/12, i datës 09.07.2020. <https://kryeministri-ks.net/wp-content/uploads/2020/07/Vendimet-nga-mbledhja-e-12-t%C3%AB-e-Qeveris%C3%AB.pdf>

Tutje, korniza për monitorimin e zbatimit të strategjisë përfshin tregues të performancës në nivelin e ndikimit ose rezultatit veçmas nga treguesit e nivelit të prodhimit. Këta tregues synojnë të matin zbatimin e planit të veprimit në nivelin e përgjithshëm dhe specifik strategjik të objektivave. Objektivat specifike përmbajnë më shumë se një tregues, të cilët kryesisht janë bazuar në indikatorët e *World Justice Project (WJP)* dhe *European Commission for the Efficiency of Justice (CEPEJ)*, por edhe indikatorë të zhvilluar për qëllime të kësaj Strategjie. Gjithashtu, tregues në nivel të aktiviteteve janë propozuar nga ana e MD, duke u dakorduar me secilin institucion përgjegjës për të qenë në nivelin e rezultateve të objektivave të përgjithshme dhe specifik, si dhe rezultateve në nivelin e aktivitetit.

Sa për ta ilustruar, gjatë hartimit të treguesve të WJP vlera bazë apo gjendja fillestare krahasimore është marrë viti 2019, ndërsa vlerat e synuara apo caqet afatmesme dhe përfundimtare janë përcaktuar vitet 2023 dhe 2026, respektivisht. Caqet e treguesve të vendosur në strategji dhe plan të veprimit do të krahasohen kundrejtë caktimit apo synimit afatmesëm të strategjisë, të cilat bazohet në metodën krahasimore, ku si pikë referimi merret mesatarja e 10 shteteve anëtare të BE-së të renditura në 10 pozitat e poshtme të renditjes tabelare të treguesve të WJP nga të dhënat e vitit bazë 2020.

Duke u bazuar në nenin 16 të Udhëzimit Administrativ Nr. 07/2018, Ministria e Drejtësisë si ministri udhëheqëse do të përgatisë 2 lloje raportesh:

- Raportin gjashtëmujor për zbatimin e planit të veprimit
- Raportin vjetor mbi zbatimin e dokumentit strategjik.

Raporti vjetor gjithëpërfshirës i progresit do të sigurojë informacione më të detajuara mbi progresin kundrejt objektivave strategjike, specifike dhe zbatimin e aktiviteteve.




Figura 3: Shprehësia e raporteve të monitorimit të strategjisë

Strategjia do t'i nënshtrohet rishikimit afatmesëm, jo më larg se deri në fillim të vitit 2024 për të vlerësuar efektivitetin dhe efikasitetin e zbatimit të planit 3-vjeçar të veprimit. Vlerësimi përfundimtar do të bëhet jo më larg se deri në vitin 2026. Të dy vlerësimet do të jenë të pavarura (të jashtme), me ç'rast Ministria e Drejtësisë do të kërkojë mbështetje të jashtme nga partnerët zhvillimor.



Figura 4: Afatet kohore në vlerësimin e strategjisë

6.0. NDIKIMI BUXHETOR DHE ZBATIMI I STRATEGJISË

Për të përcaktuar sasinë e vlerësimit të ndikimit financiar dhe buxhetor të rekomandimeve të përfshira në këtë dokument, deri në shkallën e mundshme, është kryer vlerësimi i ndikimit buxhetor në nivel të aktiviteteve, përfshirë këtu duke treguar llojin e shpenzimeve buxhetore të nevojshme për zbatimin e këtyre aktiviteteve. Për të kryer një vlerësim të tillë, ne kemi ndjekur udhëzimet për kostimin e iniciativave të reja qeveritare, ashtu siç kërkohet nga Udhëzimi Administrativ për vlerësimin e ndikimit buxhetor për iniciativat e reja qeveritare si dhe manuali i tij.

Vlerësimi i kostos së përgjithshme i paraqitur në tabelën më poshtë është llogaritur në terma bruto, për periudhën tre vjeçare 2021-2023, duke sugjeruar që potencialisht, një pjesë nga kosto e përgjithshme mund të mbulohet nga burimet ekzistuese të financimit nga buxheti i Qeverisë së Kosovës dhe potencialisht një pjesë e konsiderueshme edhe nga donatorët, përfshirë BE, Ambasada e SHBA, USAID, Ambasada e MB dhe UNDP.

Tabela 5: Vlerësimi buxhetor i Planit të Veprimit për periudhën 2021-2023 të Strategjisë së Sektorit të Sundimit të Ligjit

Objektivat strategjike	Buxheti sipas viteve		
	2021	2022	2023
I: Forcimi i sistemit gjyqësor dhe prokurorial	551,320	2,144,848	1,188,883
II: Fuqizimi i sistemit të drejtësisë penale	485,539	7,259,299	6,876,015
III: Fuqizimi i qasjes në drejtësi	1,354,218	1,301,618	1,100,861
IV: Fuqizimi i luftës anti-korrupsion	482,269	524,407	247,152
<i>Nën-totali:</i>	2,873,346	11,230,172	9,412,912
<i>Nga të cilat shpenzime kapitale:</i>	-	40,000	-
<i>Nga të cilat shpenzime të përsëritura:</i>	€ 2,873,346	€ 11,190,171	€ 9,412,912
TOTALI I PËRGJITHSHËM i buxhetit për periudhën e zbatimit të Planit të Veprimit 2021-2023:	€ 23,516,430		

Duke u bazuar në të dhënat e mësipërme faktike mbi vlerësimin e ndikimit buxhetor dhe zbatimin e planit të veprimit, mund të konkludojmë si në vijim:

- Vlerësimi i përgjithshëm i kostos së Strategjisë së Sektorit të Sundimit të Ligjit, specifikisht Planit të saj të Veprimit (2021-2023) është **23,516,430 EUR**
 - Objektivi strategjik I: *Forcimi i sistemit gjyqësor dhe prokurorial* kap shifrën nën-totale prej **3,885,051 EUR**
 - Objektivi strategjik II: *Fuqizimi i sistemit të drejtësisë penale* kap shifrën nën-totale prej **14,620,853 EUR**
 - Objektivi strategjik III: *Fuqizimi i qasjes në drejtësi* kap shifrën nën-totale prej **3,756,698 EUR**
 - Objektivi strategjik IV: *Fuqizimi i luftës anti-korrupsion* kap shifrën nën-totale prej **1,253,828 EUR**




Figura 5: Ndarja sipas përqindjes së vlerësimit të kostos sipas objektivave strategjike

Analizuar nga perspektiva e klasifikimit të buxhetit, përkatësisht nga perspektiva e kategorive ekonomike, implikimet në kosto të rekomandimeve hyjnë kryesisht nën kategorinë 'Paga dhe mëditje', e përcjellur nga 'mallra dhe shërbime', dhe të dyja këto kategori hyjnë nën 'shpenzime të përsëritura'. Tabela në vijim ofron informacion më të hollësishëm për kostot indikative, sipas kategorive ekonomike buxhetore.

Në këtë kontekst, nga të dhënat e mësipërme faktike të koston, mund të konkludojmë si në vijim:

- Gjatë vitit 2021, vlerësimi buxhetor i koston në zbatimin e planit të veprimit është **2,873,346 EUR**
- Gjatë vitit 2022, vlerësimi buxhetor i koston në zbatimin e planit të veprimit është **11,230,172 EUR**
- Gjatë vitit 2023, vlerësimi buxhetor i koston në zbatimin e planit të veprimit është **9,412,912 EUR**
- Pjesa dërrmuese e koston hyn nën kategorinë 'Paga dhe mëditje', specifikisht shuma prej **13,644,651 EUR** që përbën përafërsisht 58% të koston totale të zbatimit
- Kostoja e përgjithshme e vlerësuar nën kategorinë 'Mallra dhe Shërbime' është **9,817,979 EUR**, që përbën përafërsisht 41.7% të koston totale të zbatimit
- Vlerësimi i përafërt i koston nën kategorinë 'Shërbime Komunale' është **13,800 EUR**
- Vlerësimi i përafërt i koston nën kategorinë 'Shpenzime Kapitale' është **40,000 EUR**

Tabela 6: Shpërndarja e koston sipas kategorive ekonomike të zbatimit të Planit të Veprimit për periudhën 2021-2023 të Strategjisë së Sektorit të Sundimit të Ligjit

Kategoritë ekonomike	2021	2022	2023	Total
Pagat dhe mëditjet	1,473,236	6,250,632	5,920,782	13,644,651
Mallrat dhe shërbimet	1,397,350	4,975,400	3,445,229	9,817,979
Shërbime komunale	2,760	4,140	6,900	13,800
Subvencionet dhe transferet	-	-	-	-
Shpenzimet kapitale	-	-	40,000	40,000
TOTAL	€ 2,873,346	€ 11,230,172	€ 9,412,911	€ 23,516,430

Në tabelën më poshtë është paraqitur një pasqyrë më e detajuar e shpërndarjes së koston së vlerësuar të Planit të Veprimit të Strategjisë së Sektorit të Sundimit të Ligjit sipas objektivave strategjike dhe qëllimeve specifike:

Tabela 7: Pasqyrë e hollësishme e shpërndarjes së vlerësuar të kostos sipas objektivave strategjike dhe qëllimeve të Strategjisë / Planit të Veprimit

Objektivi strategjik i Planit të Veprimit (2021-2023)	2021	2022	2023	Σ
Objektivi strategjik I: Forcimi i sistemit gjyqësor dhe prokurorial	551,320	2,144,848	1,188,883	3,885,051
Qëllimi specifik I.1: Ngritja e llogaridhenies së Sistemit Gjyqësor dhe atij Prokurorial	38,285	406,429	249,796	694,510
Qëllimi specifik I.2: Ngritja e efikasitetit të sistemit gjyqësor dhe prokurorial	332,886	1,533,880	794,080	2,660,846
Qëllimi specifik I.3: Ngritja e profesionalizmit dhe kompetencës në sistemin gjyqësor dhe prokurorial	51,323	95,423	59,065	205,811
Qëllimi specifik I.4: Përmirësimi i integritetit të gjyqtarëve dhe prokurorëve	128,826	109,115	85,942	323,884
Objektivi strategjik II: Fuqizimi i sistemit të drejtësisë penale	485,539	7,259,299	6,876,015	14,620,853
Qëllimi specifik II.1: Fuqizimi i luftës kundër krimit të organizuar dhe korrupsionit të nivelit të lartë	39,446	36,761	31,115	107,322
Qëllimi specifik II.2: Ngritja e profesionalizmit në luftën kundër krimit të organizuar, korrupsionit të nivelit të lartë dhe pastrimit të parave	90,704	75,350	75,350	241,404
Qëllimi specifik II.3: Fuqizimi i Sistemit për Ekzekutimin e Sanksioneve Penale	190,378	32,737	23,864	246,980
Qëllimi specifik II.4: Forcimi i integritetit të Policisë së Kosovës	165,012	7,114,451	6,745,685	14,025,148
Objektivi strategjik III: Fuqizimi i qasjes në drejtësi	1,354,218	1,301,618	1,100,861	3,756,698
Qëllimi specifik III.1: Përmirësimi i qasjes në gjykata dhe prokurori	224,245	236,042	231,151	691,438
Qëllimi specifik III.2: Ngritja e efikasitetit dhe efektivitetit të mjeteve juridike	259,115	231,031	283,592	773,738
Qëllimi specifik III.3: Përmirësimi i Shërbimeve të Profesioneve të Lira	644,883	632,091	365,663	1,642,638
Qëllimi specifik III.4: Rritja e rolit mbikëqyrës dhe avokues të organizatave të shoqërisë civile	69,634	69,634	87,634	226,903
Qëllimi specifik III.5: Fuqizimi i rolit të Ministrisë së Drejtësisë në procesin e anëtarësimit në Bashkimin Evropian	156,340	132,821	132,821	421,981
Objektivi strategjik IV: Fuqizimi i luftës anti-korrupsion	482,269	524,407	247,152	1,253,828
Qëllimi specifik IV.1: Përmirësimi i kornizës institucionale për luftimin e korrupsionit	429,274	486,029	230,322	1,145,625
Qëllimi specifik IV.2: Përmirësimi i sistemit të deklarimit të pasurisë dhe rregullativës për pranimin e dhuratave	52,995	38,378	16,830	108,203
Totali i përgjithshëm (I+II+III+IV):	2,873,346	11,230,172	9,412,912	23,516,430

7.0. PLANI I VEPRIMIT DHE ZBATIMI I DOKUMENTIT

Dokumenti i bashkëngjitur në formatin Excel.